



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

*"Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës
dhe gazit në zonën Patos-Marinëz"*

Tiranë, 2025

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	5
1.1 Konteksti i problemit social	5
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM	6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim	10
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	11
2.4 Pesha në buxhet	12
2.5 Feedback-u i subjektit në fazën studimore dhe të terrenit.	13
3. DETAJET E AUDITIMIT	13
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	13
3.2 Objektivi i auditimit	14
3.3 Pyetjet e auditimit	15
3.4 Fushëveprimi i auditimit	15
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE	15
4.1.1 A kanë hartuar institucionet përgjegjëse, politika të përshtatshme për mbrojtjen e mjedisit në zonën objekt auditimi?	16
4.1.2 A janë përmbushur objektivat strategjikë për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit?	17
4.2.1 Si paraqitet gjendja e mjedisit në zonën Patos-Marinëz?	19
4.2.2 A është garantuar nga institucionet përgjegjëse monitorimi, inspektimi, raportimi i treguesve mjedisore lidhur me aktivitetin e shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz?	29
4.3.1 A ka të dhëna shëndetësore dhe/ose studime epidemiologjike të kryera për banorët e zonës objekt auditimi?	37
4.4 Si janë shpenzuar nga bashkitë, të ardhurat e realizuar nga taksat, që paguajnë kompanitë e nxjerrjes së naftës?	49
5. ANEKSE	56

PËRMBLEDHJE

Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi...¹

Nëpërmjet auditimit me temë “*Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz*” është synuar vlerësimi dhe analizimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga nxjerrja e naftës. Gjithashtu, për të siguruar që politikat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të jenë efektive dhe të integruara për sigurimin e një ekuilibri midis ruajtjes së mjedisit, shëndetit dhe zhvillimit ekonomik.

Nëpërmjet këtij auditimi u analizua në mënyrë objektive dhe të paanshme veprimtaria e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Bashkive Patos, Roskovec, Fier, Kuçovë, Mallakastër për periudhën 2021-2024, për të parë se deri në çfarë mase kanë qenë efektive dhe eficiente veprimtaria e bashkëpunimi i këtyre institucioneve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në zonën Patos-Marinëz.

Në përfundim të auditimit u evidentua se: nuk ka një strategji për sektorin hidrokarbur dhe shëndetin mjedisor, rregullorja e naftës dhe e gazit ka "vakum ligjor"; edhe pse kanë kaluar 8 vite nga miratimi, ende nuk është ngritur Instituti Shkencor i Hidrokarbureve; inspektorët e mjedisit nuk janë të pajisur me pajisje matëse për të verifikuar zbatimin e kushteve të lejes mjedisore; bashkitë nuk kanë miratuar planet e veprimit vendor për mjedisin dhe planet e cilësisë së ajrit; gjendja e mjedisit në zonën Patos-Marinëz nuk është sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin mjedisor; në zonën Patos-Marinëz nuk ka një stacion të monitorimit të treguesve të mjedisit; raportet e gjendjes së mjedisit nuk paraqesin të dhëna për treguesit mjedisor për zonën Patos-Marinëz; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk siguron informacion në kohë reale për publikun, në rast të kapërcimit të parametrave ndotës; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk ka kryer mbikëqyrje të plotë për subjektet hidrokarbure; Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer ri-inspektime për korrigjimin e shkeljeve; sipas procesverbaleve të mbajtura nga inspektorët, nuk janë marrë asnjëherë mostrat e substancave; subjekti Albpetrol sh.a nuk ka dorëzuar raportet e vetmonitorimit; subjektet e nxjerrjes së naftës në Patos-Marinëz nuk kanë dorëzuar cdo transfertë të mbetjeve të rrezikshme nëpërmjet sistemit e-Albania; 2 gropa ekologjike të Albpetrol sh.a nuk janë të pajisura me leje mjedisi; hotspoti mjedisor Patos-Marinëz nuk ka një studim epidemiologjik; investimet në përmirësimin e treguesve mjedisore, në raport me të ardhurat nga tarifa e ndotjes, në bashkitë Patos dhe Roskovec, janë minimale.

¹ Ligji Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 6

Lista e shkurtimeve

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
TVSH	Tatim mbi vlerën e shtuar
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

*"Nafta është shndërruar në një rrezik për mundësitë dhe mbijetesën tonë mbi këtë planet".
Dennis Weaver.*

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.²

Fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinëz është nga më të mëdhatë në Europë, përse i përket rezervave të naftës.

Referuar të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për vitin 2024, subjektet e shfrytëzimit të naftës dhe gazit natyror në zonën Patos-Marinëz kanë prodhuar 513, 318 ton naftë.

Banorët që jetojnë kryesisht në zonën Patos-Marinëz janë të ekspozuar nga niveli i lartë i ndotjes në mjedis, i cili shkaktohet nga nxjerrja e naftës në këtë zonë. Situata e deritanishme paraqitet e rënduar, e konfirmuar edhe nga raportet e gjendjes së mjedisit.

Në raportet e gjendjes së mjedisit, të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasqyrohet, se ujrat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë ndoten seriozisht nga pusët e naftës, gjatë nxjerrjes me pompa, nga tubacionet dhe impiantet e paratrajtimin dhe në ajër shkarkohen gazi sulfurik dhe hidrokarbure të ndryshme.

Nga ana tjetër, vërehet një gjendje shëndetësore e banorëve e ndikuar negativisht nga gjendja mjedisore e zonës dhe kryesisht cilësia e ajrit dhe uji i pijshëm të zonës. Për sa u takon dëmeve ekonomike, gjendja mjedisore dhe shëndetësore ndikon direkt në sistemin e prodhimit ekonomik të zonës, rendimentin e ulët të prodhimit bujqësor dhe rritjen e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor³. Sipas një raporti mbi vlerësimin e gjendjes mjedisore dhe shëndetësore në fshatin Patos-Marinëz të përgatitur nga Instituti i Shëndetit Publik (në vitin 2015), simptomat që banorët paraqesin janë: nauze, marrje mendsh, tharje dhe djegie fyti, gjendje përgjumje, konfuzion i lehtë, dridhje, djersitje, aritmi, dhimbje koke, këputje trupore etj.

Pavarësisht, përpjekjeve që janë bërë për të përmirësuar situatën, nga pamja vizuale dhe ankesat e vazhdueshme të banorëve në institucionet shtetërore, situata mbetet shqetësuese si nga ana mjedisore ashtu dhe në drejtim të ruajtjes së shëndetit të popullatës. Nxjerrja e naftës është një proces që shoqërohet me impakte në mjedis dhe në shëndet, si i tillë kërkon monitorim të vazhdueshëm mjedisor dhe standarte mjedisore të qarta.

Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë ka konstatuar se për të siguruar përparim në acquis komunitare për mjedisin (tokë, ujë, ajër), Shqipëria duhet të rrisë ndjeshëm burimet buxhetore dhe kapacitetin zbatues të agjencive kryesore kombëtare të mjedisit dhe të miratojë një plan zhvillimi kapacitetesh. Përveç kësaj, monitorimi i cilësisë së mjedisit është i pamjaftueshëm.

Në median vizive dhe të shkruar vazhdojnë të raportohen problematika lidhur me ndotjen e mjedisit në zonën Patos-Marinëz, ku pusët e naftës në zonë përbëjnë rrezik serioz për shkatërrimin e mjedisit, tokës bujqësore dhe ujërave, si dhe shëndetin e banorëve të zonës, ndërsa autoritetet shtetërore kanë dështuar në marrjen e masave dhe kanë toleruar paligjshmërinë dhe ndotjen.⁴

Nëse koncepti i mirëqenies ka qenë më parë i lidhur ngushtë më të mirat materiale dhe zhvillimin ekonomik, sot është më i lidhur me aspekte të tjera, si shëndeti, mjedisi, marrëdhëniet shoqërore të lidhura ngushtësisht me perceptimin subjektiv të çdo individi. Kushtet e jetesës së njeriut janë të varura nga ekosistemi në të cilin ai jeton, kështu që është e nevojshme që të mbrojmë dhe të ruajmë mjedisin, në mënyrë që të sigurojmë një kualitet jete të qëndrueshëm, për gjeneratat e së tashmes dhe së ardhmes.⁵

² Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit", neni 4.

³ Ndotjet që vijnë nga hidrokarburet.

⁴ <https://www.reporter.al/2024/12/20/avokati-i-popullit-kerkon-hetime-per-ndotjen-alarmante-ne-patos-marinze/>

⁵ Vendim nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit".

Nisur nga situata ndotëse e mjedisit, duke rrezikuar shëndetin e qytetarëve, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka gjykuar të rëndësishëm kryerjen e këtij auditimi duke u fokusuar në ndikimin në mjedis dhe shëndet të aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz.⁶

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet economiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247, datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin e performancës me temë “Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz”. Ndikimi i subjekteve të shfrytëzimit të naftës dhe gazit natyror në mjedis dhe shëndet, përmbushja e kushteve të lejes mjedisore si dhe marrëveshjes së hidrokarbureve në zonën Patos-Marinëz dhe roli i institucioneve publike që monitorojnë këto subjekte, konsiderohen çështje të ndjeshme.

KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale mjedisore dhe impaktin në shëndet nga aktiviteti i shfrytëzimit të naftës dhe gazit natyror në fushën naftëmbajtëse “Patos- Marinëz”, si dhe rolin e institucioneve shtetërore në lidhje me zbatimin e legjisllacionit mbi operacionet e hidrokarbureve nga subjektet që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure dhe janë të pajisur me leje mjedisi.

Në përfundim do të jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:


1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
5. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
6. Instituti i Shëndetit Publik;
7. Bashkia Patos;
8. Bashkia Roskovec;
9. Bashkia Fier;
10. Bashkia Mallakastër;
11. Bashkia Kuçovë.

⁶ Informacion për zonat naftëmbajtëse në territorin e Albpetrol sh.a , me nr. 862 prot., datë 26.06.2024.

➤ **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, monitorimin e cilësisë së ujërave etj.⁷

Figura 1. Organigrama e strukturës përgjegjëse në MTM dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit



Burimi: MTM dhe AKM

Përpunoi: Grupi i auditimit

Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, në përmbushje të rolit të saj, nëpërmjet strukturave përgjegjëse në ministri (Drejtorinë e Ndryshimeve Klimatike) ka këto përgjegjësi:

- Planifikon hartimin ose përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me mbrojtjen e natyrës, si dhe përafron legjislacionin vendas me atë europian në fushën që mbulon drejtoria.
- Menaxhon politika lidhur me masat për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e politikave të menaxhimit të ndryshimeve klimatike, ajrit e kimikateve, me qëllim hartimin e programeve për zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor.
- Propozon, harton politika dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të politikave të zhvillimit të ndryshimeve klimatike, ajrit, kimikateve, etj.
- Drejton dhe koordinon hartimin e programit kombëtar të monitorimit të ajrit, shkarkimeve në ajër, kimikateve, sasisë të shkarkimeve të gazta, të lëngëta dhe të ngurta.
- Evidenton prioritetet për ndryshimet klimatike, cilësinë e ajrit në mjedis, menaxhimin e kimikateve.

➤ **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)**

AKM-ja ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

AKM-ja ka këto funksione kryesore:

1. Sigurimin e performancës mjedisore;
2. Kërkimin dhe dijen mjedisore;
3. Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licencimin;

⁷“Rregullore e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e MTM”, Neni 3, pika 1.


4. Inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.⁸

➤ **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)**

MIE, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.504, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

-Fushën e energjisë dhe industrisë.

Figura 2. Organigrama e strukturës përgjegjëse në MIE dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore



Burimi: MIE dhe AKBN

Përpunoi: Grupi i auditimit

Organigrama e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfshin Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në fushën e Hidrokarbureve, në të cilën është pjesë: Sektorin e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Naftës dhe Sektorin e Programeve të Zhvillimit në fushën e Gazit Natyror i cili ka kompetencë:

-Harton programe të zhvillimit në sektorin energjetik hidrokarbur;

-Programon, organizon dhe koordinon punën për hartimin, ndjekjen dhe realizimin e programeve, strategjive dhe projekteve të zhvillimit në aktivitetin e sektorit energjetik hidrokarbur në shkallë vendi, të shoqëruara këto me politikat përkatëse, për të garantuar një zhvillim të sigurt dhe me eficiencë të këtij sektori, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në MIE.

-Bashkëpunon dhe bashkërendon punën në promovimin e investimeve të reja për kërkim-prodhimin e hidrokarbureve, si dhe në përgatitjen, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure ndërmjet shoqërive investitore dhe autoriteteve përgjegjëse të shtetit shqiptar;

-Bashkëpunon në programimin e projekteve dhe detyrave lidhur me trajtimin zgjidhës të çështjeve të ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit në sektorin energjetik hidrokarbur, si dhe të ndikimit që potencialisht jep ky sektor në çështjen e mjedisit në tërësi;

-Bashkëpunon në trajtimin zgjidhës të çështjeve të rritjes së sigurisë teknike në impiantet dhe instalimet për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, duke kërkuar angazhimin në këtë proces të specialistëve të fushës, të pajisur me certifikatat dhe lejet e nevojshme.⁹

⁸ Vendim nr.568, datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", pika 2.

⁹ Rregullore e Brendshme e MIE.

➤ **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore**

AKBN-ja ka si objekt të veprimtarisë së saj, ndjekjen, mbikqyrjen e veprimtarisë hidrokarbure, në bazë të politikave qeverisëse.

Organigrama e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përfshin Drejtorinë e Hidrokarbureve, në të cilën bën pjesë: Sektori i Mbikqyrjes së Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë hidrokarbureve, i cili ka kompetencë;

-Merr pjesë në grupet e ngritura nga AKBN-ja për mbikqyrjen, kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e detyrimeve kontraktore të Licensë-Marrëveshjeve dhe Marrëveshjeve Hidrokarbure në lidhje me Ndikimin në Mjedis, duke rekomanduar që ato të kryhen në përputhje me programet e miratuara dhe me normat e standartet ndërkombëtare;

-Në bashkëpunim me Sektorët e tjerë të Drejtorisë së Hidrokarbureve ndjek dhe mbikqyr Ndikimin në Mjedis gjatë kërimit, vlerësimit, zhvillimit, prodhimit dhe realizimit të investimeve të parashikuara në frymën e Licensë-Marrëveshjeve dhe të Marrëveshjeve Hidrokarbure sipas Planeve të Zhvillimit të miratuara dhe Programeve të Punës Vjetore, të shoqërive që operojnë në fushën e naftës dhe gazit në Shqipëri;

-Mban lidhje të vazhdueshme me shoqërinë Albpetrol dhe të gjithë shoqëritë që operojnë në zonat e vendburimeve ekzistues të naftës dhe të gazit dhe blloqet e kërimit në lidhje me Ndikimin në Mjedis dhe në rast se konstatohen probleme, kërkon prej tyre operimin e mëtejshëm në përputhje me Licencat dhe Marrëveshjet Hidrokarbure;

-Ndjek realizimin e treguesve të raportuar nga shoqëritë, në kuadër të marrëveshjeve që Albpetrol sh.a. ka lidhur me shoqëritë, për Ndikimin në Mjedis.


➤ **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin përkatës, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor;

b) zhvillimin dhe monitorimin e politikave të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe me treguesit shëndetësorë të popullatës.¹⁰

Figura 3. Organigrama e MSHMS-së dhe e Institutit të Shëndetit Publik



➤ **Instituti i Shëndetit Publik**

Instituti i Shëndetit Publik është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë¹¹. ISHP-ja është qendër e kërimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni.

Instituti i Shëndetit Publik kryen këto funksione: a) mbikqyrjen epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe joinfektive; b) menaxhimin e regjistrave kombëtarë; c) kërkimin shkencor në shëndetin publik; ç) ndjekjen e të rejave shëndetësore ndërkombëtare, përfshirë sistemet dhe praktikat; d) trajnimin dhe edukimin universitar në shëndetin publik; dh) është qendër reference në shëndetin publik; e) informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik. Organigrama e ISHP-së përfshin Njësinë e Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqeve të Shëndetit Publik.

¹⁰ Rregullore e MSHMS, Neni 3, pika 3/a, 3/b.

¹¹ Ligji nr.10 138, datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik", neni 12.


➤ **Bashkitë:**

- Patos;
- Roskovec;
- Mallakastër;
- Fier;
- Kuçovë.¹²

NJQV-të janë përgjegjëse për:

- a) miratimin e planeve vendore të cilësisë së ajrit;
- b) sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
- c) zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Figura 4. Organigrama e strukturës përgjegjëse në Bashkitë Patos, Roskovec, Fier, Mallakastër, Kuçovë



2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

1. Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji Nr.10463, datë 09.06.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i përditësuar;
- Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i përditësuar;
- Ligji Nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” i ndryshuar;
- Ligji Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 480, datë 31.7.2018 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030”;
- VKM Nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Vendim Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

¹² Në këtë auditim janë përfshirë edhe bashkitë Mallakastër, Fier, Kuçovë, për shkak se janë zona të prodhimit të naftës.

- Të tjera.
- 2. Kriteret teknike dhe të monitorimit:**
 - VKM Nr. 1189.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit;
 - VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”;
 - VKM Nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;
 - Rregullore “Për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licencë marrëveshjeve”, miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
 - Udhëzim Nr. 811, datë 20.11.2018 “Mbi miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve nga shpimi i puseve për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri”;
 - Raportet e Gjendjes së Mjedisit;
 - Marrëveshja hidrokarbure “Vendburimi Patos – Marinëz ndërmjet Albpetrol sh.a dhe Saxon International Energy Ltd, datë 19.06.2004”;
 - Të tjera.
- 3. Praktika të mira**
 - Udhëzimet e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë për Termialet e naftës bruto dhe produkteve të naftës, Banka Botërore, prill 2007¹³;
 - Ndikimi i kërkimit të naftës dhe degradimi i mjedisit¹⁴

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr.412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”.

Ky plan ndjek dy objektiva:

-përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat ku janë tejkuluar limitet e vendosura me ligj, si dhe në zonat ku ekziston një risk i lartë i tejkalimit të këtyre limiteve;

-ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në pjesën e ngelur të territorit.

Këto objektiva do të arrihen duke implementuar masa, për të mos lejuar dhe për të reduktuar, burimet industriale, me qëllim për t’iu përmbajtur limiteve të përcaktuara nga ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”. Nga të dhënat e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së ajrit, zonat industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Në zonën e Fierit, matjet indikative kanë regjistruar probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës. Shumë “pellgje vajrash” në zonën e Fierit kontribuojnë në një emëtim të konsiderueshëm të hidrokarbureve.

Nga ana tjetër, qëllimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë është zhvillimi i një sektori energjistik efektiv që nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjistik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve ekonomik dhe shoqëror.

Njësitë e qeverisjes vendore (NQV) adoptojnë dhe zbatojnë planet lokale të menaxhimit të cilësisë së ajrit; sigurojnë në nivel vendor, masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit për periudhën objekt auditimi ka hartuar dhe publikuar Raportet e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2021, 2022 dhe 2023, mbi bazën e monitorimeve të kryera në stacionet e monitorimit statik. Bazuar në VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për

¹³ <https://documents1.worldbank.org/curated/zh/224701496124240982/pdf/115327-WP-ENGLISH-Crude-Oil-and-Petroleum-PUBLIC.pdf>

¹⁴ https://globaljournals.org/GJHSS_Volume18/4-The-Impact-of-Oil-Exploration.pdf

rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton cdo vit Raportin e Gjendjes së Mjedisit , si mjet i vlerësimit të gjendjes dhe cilësisë së mjedisit në tërësi.

Nga ana tjetër, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në zbatim të Vendimit nr.547, datë 09.08.2006 (i përditësuar), mbikëqyr veprimtarinë hidrokarbure.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni përgjegjës për politikën e shëndetit mjedisor, e cila nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, përgatit raportet vjetore për gjendjen shëndetësore të popullatës së vendit.

2.4 Pesha në buxhet

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me Vendim të Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribueshëm për aktivitetin në fjalë. Treguesit e matshëm buxhetor për vitet 2021-2024 të të ardhurave të realizuara nga taksat (renta minerare), tarifat (tarifë ndotje), pesha e tyre në buxhet në raport me të ardhurat e realizuara paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 1: Peshë në Buxhet e të ardhurave nga renta minerare dhe tarifa e ndotjes


000/lekë

Nr.	Bashkia	Përshkrimi i të ardhurave	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
1.	Patos	Renta Minerare	79,468	71,246	75,434	75,434
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>32.4%</i>	<i>35%</i>	<i>31%</i>	<i>26.3%</i>
		Tarifë ndotje	47,985	40,250	41,103	41,979
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>19.6%</i>	<i>19.7%</i>	<i>17.1%</i>	<i>14.6%</i>
		Totali	127,453	111,496	116,537	117,413
2.	Fier	Renta Minerare	21,765	27,911	23,214	19,851
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>2.8%</i>	<i>3.8%</i>	<i>2.8%</i>	<i>2.2%</i>
		Tarifë ndotje	-	-	-	-
		Totali	21,765	27,911	23,214	19,851
3.	Roskovec	Renta minerare	36,645	54,061	39,640	35,737
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>14.6 %</i>	<i>17.7 %</i>	<i>15.7 %</i>	<i>13.3 %</i>
		Tarifë ndotje	-	-	-	2,000
		<i>Pesha në buxhet</i>	-	-	-	<i>0.7</i>
		Totali	36,645	54,061	39,640	37,737
4.	Kuçovë	Renta Minerare	214	4,152	2,165	2,462
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>1.0%</i>	<i>2.0%</i>	<i>1.0%</i>	<i>1.8%</i>
		Tarifë ndotje	34,821	31,820	36,000	38,300
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>16.9%</i>	<i>15.6%</i>	<i>17.1%</i>	<i>16.9%</i>
		Totali	35,036	35,972	38,165	40,762
5.	Mallakastër	Renta Minerare	2,612	1,070	1,377	2,741
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>1.2%</i>	<i>0.63 %</i>	<i>0.72%</i>	<i>1.5%</i>
		Tarifë ndotje	34,144	45,374	25,553	55,977
		<i>Pesha në buxhet</i>	<i>16.2 %</i>	<i>26.9 %</i>	<i>12.3 %</i>	<i>31.4 %</i>
		Totali	36,756	46,444	26,930	58,718

Burimi: Bashkia Patos, Fier, Roskovec, Kuçovë, Mallakastër

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Grafik nr.1: Peshë në buxhet.



Burimi: Bashkia Patos, Fier, Roskovec, Kuçovë, Mallakastër

Përpunoi: Grupi i Auditimit

2.5 Feedback-u i subjektit në fazën studimore dhe të terrenit.

Subjektet e përfshira në këtë auditim gjatë fazës studimore dhe të terrenit janë treguar përgjithësisht të gatshëm dhe të hapur ndaj grupit të auditimit, duke vendosur në dispozicion dokumentet e kërkuara sipas afateve të përcaktuara nga grupi i auditimit. Informacioni i kërkuar është vënë në dispozicion i plotë në format elektronik dhe fizikisht sipas nevojës së grupit auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me fushën e menaxhimit të aktivitetit të hidrokarbureve. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës, grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.





Tabela 2: Analiza e Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1.	Mungesa e përditësimit të kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore në fushën e mjedisit dhe shëndetit.	Risk Strategjik	I lartë
2.	Mungesa e strukturave të dedikuara për monitorimin e mjedisit pranë NJQV.		I lartë
3.	Mospërdorimi i të ardhurave të realizuara nga shfrytëzimi i naftës dhe gazit, në funksion të mirëmbajtjes dhe garantimit të standardeve mjedisore.	Risk Financiar	I lartë
4.	Numri i lartë i institucioneve të përfshira në procesin e inspektimit dhe monitorimit në tërësi.	Risk Rregullator dhe Juridik	I mesëm
5.	Mungesë e transparencës me publikun.	Risk Operacional	I lartë

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz” ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e ndikimit në mjedis dhe shëndet që vjen nga shfrytëzimi i naftës dhe gazit, si dhe adresimin e masave që duhen marrë nga institucionet përgjegjëse në rast të ndotjes mjedisore. Në këtë mënyrë është siguruar një vlerësim i paanshëm dhe objektiv, mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë mbi monitorimin e cilësisë së mjedisit (ujë, ajër, tokë) si dhe masat për mbrojtjen e shëndetit (nga faktorët mjedisorë) në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Me anë të këtij objektivi është konkluduar se deri në çfarë mase kanë qenë efektive dhe eficiente veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi për periudhën 2021-2024.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur si fushëveprim analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi politikat e ndërmarra dhe administrimin e proceseve të hidrokarbureve në zonën Patos-Marinë, inspektimet, monitorimet e kryera në subjektet e shfrytëzimit të naftës dhe gazit etj, me synimin për të garantuar cilësinë e jetës nga pikëpamja mjedisore dhe shëndetësore.

Periudha e auditimit është për vitet 2021-2024. Gjatë këtij auditimi jemi fokusuar në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë; Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e varësisë; Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e varësisë; Bashkinë Fier; Roskovec; Kuçovë; Patos; Mallakastër. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur si edhe periudha e auditimit prej vitit 2021 është për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave, procedurave të ndjekura si dhe veprimtarinë që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të përmbushjes së objektivave të tyre afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

4.SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja kryesore: *A janë marrë masat e duhura për të minimizuar ndikimin negativ në mjedis dhe shëndet, nga aktiviteti i shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinë?*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi i auditimit arriti në këtë mesazh auditimi:

Mesazhi i auditimit:

Mungesa e një kuadri të integruar rregullator, mungesa e stacioneve të monitorimit të treguesve të mjedisit, mungesa e inspektimeve dhe monitorimeve në mënyrë periodike, ka krijuar boshllëqe serioze në kontrollin dhe parandalimin e ndotjes mjedisore si dhe në identifikimin e risqeve në shëndetin publik.

Gjithashtu, është vërejtur një mungesë koordinimi ndërinstytucional dhe jo transparent në publikimin e të dhënave, çka ka kufizuar aftësinë për të reaguar në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme ndaj problematikave të konstatuara në zonat e prekura. Në aspektin shëndetësor, mungesa e të dhënave të detajuara dhe studimeve të thelluara mbi impaktin shëndetësor të ndotjes në komunitetin që jeton në këtë zonë, nuk ka mundur vlerësimin e rrezeve dhe planifikimin e masave për mbrojtjen e shëndetit publik.

Në nivel vendor, investimet e kryera për riaftësimin dhe rehabilitimin mjedisor, kanë qenë minimale dhe të pamjaftueshme në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit në këtë zonë.

Masat e marra nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në zonën Patos-Marinëz nuk kanë qenë të mjaftueshme.

4.1 A kanë qenë efektive politikat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit?

4.1.1 A kanë hartuar institucionet përgjegjëse, politika të përshtatshme për mbrojtjen e mjedisit në zonën objekt auditimi?

➤ *Bashkitë nuk kanë miratuar planet e veprimit vendor për mjedisin.*

Sipas ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”, bashkitë duhet të përgatisin planet e veprimit vendor për mjedisin, në përputhje me strategjitë dhe planet mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.¹⁵

Planet e veprimit vendor për mjedisin janë të domosdoshëm për qeverisjen lokale, pasi ato përshkruajnë të gjitha projektet në nivel vendor që përmirësojnë situatën e mjedisit në territorin përkatës, duke listuar problematikën dhe nevojat mjedisore.

Referuar kthimit të përgjigjes me email, nga bashkitë objekt auditimi (bashkia Patos, Roskovec, Fier, Kuçovë, Mallakastër), NJQV e mësipërme nuk kanë miratuar ende planet vendore të veprimit të mjedisit.

➤ *Bashkitë nuk kanë miratuar planin e cilësisë së ajrit.*

Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, përkufizon ndër të tjera edhe Planin e cilësisë së ajrit. Plani i cilësisë së ajrit duhet të përfshijë masa specifike që synojnë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë, përfshirë fëmijët.

Bashkitë, kur përgatitin planet e cilësisë së ajrit duhet të bashkëpunojnë me ministritë e linjës, AKM-në dhe ARM-të. Pasi përgatisin draftin, njësitë e qeverisjes vendore duhet të dërgojnë projektin e planit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në ministritë përkatëse për komente, të cilat duhet të merren në konsideratë për përmirësimin e tij. Konsiderohet se nuk ka komente, nëse ato nuk dërgohen brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Në vijim, Bashkia duhet të publikojë projektplanin e cilësisë së ajrit, në faqen e saj elektronike zyrtare dhe duhet ta bëjnë të disponueshëm për komente për publikun. Këshillat bashkiakë miratojnë planin e zonës, pasi sigurohen se pjesëmarrja e publikut dhe këshillimi janë kryer në përputhje me legjislacionin e posaçëm.

¹⁵ Ligji nr.10443, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, neni 22.

1.Gjetje nga auditimi: Referuar legjislacionit mjedisor në fuqi¹⁶, njësitë e qeverisjes vendore duhet të përgatisin planet vendore të ajrit dhe mjedisit, që përfshijnë monitorimin e treguesve mjedisorë. Nga auditimi rezultoi se Bashkitë Patos, Roskovec, Fier, Kuçovë, Mallakastër nuk kanë miratuar planet e veprimit vendor për mjedisin si dhe planin e cilësisë së ajrit. Mungesa e planeve të cilësisë së ajrit dhe planeve vendore të mjedisit sjell mosmarrjen e masave nga njësitë e qeverisjes vendore, për indikatorët e mjedisit në tërësi.

1.Konkluzion: Organet e pushtetit vendor nuk kanë marrë masa për përgatitjen e planeve vendore të mjedisit, si dhe nuk iu kanë siguruar qytetarëve, të dhëna të mjaftueshme për gjendjen e mjedisit.

1.1.Rekomandim: Kryetarët e Bashkive Patos, Roskovec, Fier, Kuçovë, Mallakastër të ngrënë grupe pune për të përgatitur planet e cilësisë së ajrit dhe planet për mjedisin në nivel bashkie si dhe të koordinojnë punën me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit deri në miratimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.2 A janë përmbushur objektivat strategjikë për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin?

➤ *Nuk ka një strategji për sektorin hidrokarbur dhe shëndetin mjedisor.*

-Referuar “Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030” miratuar me VKM Nr. 480, datë 31.7.2018 "Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë (SKE) për Periudhën 2018–2030”, qeveria ka përcaktuar që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duhet të zhvillojë mekanizma për politika dhe strategji të përshtatshme të sektorit hidrokarbur. Nga auditimi u konstatua se MIE nuk ka inicuar mekanizma për politika dhe strategji të përshtatshme të sektorit hidrokarbur.

Ndërkohë, në përgjigjen e pyetësorit drejtuar grupit të auditimit, MIE citon se *“Reformat institucionale janë kritike për të përmirësuar menaxhimin e nevojshëm për të drejtuar në mënyrë efektive zhvillimin racional të sektorit aktual të naftës dhe gazit në vend”*.¹⁷

-Ligji “Për Shëndetin Publik” përkufizon termin “shëndet mjedisor”. Tërësia e masave në shëndetin mjedisor përfshin monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të mjedisit në shëndet, mbikëqyrjen e normave higjieno – shëndetësore, edukimin qytetar për mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit, si dhe ndërhyrjen për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të efekteve mjedisore në shëndet¹⁸.

Referuar Strategjisë Globale të Organizatës Botërore të Shëndetësisë “Për shëndetin, mjedisin dhe ndryshimet klimatike”, një nga objektivat strategjikë është që, sektori i shëndetësisë të luajë rol udhëheqës dhe koordinues, së bashku me sektorë të tjerë që kanë rëndësi për shëndetin, mjedisin dhe ndryshimet klimatike për të përmirësuar jetën.

Sektori i Shëndetësisë është drejtpërdrejtë i përfshirë, pasi është i detyruar të trajtojë sëmundje akute dhe kronike për shkak të rreziqeve mjedisore dhe trajtimi i tyre duhet të përsëritet duke pasur parasysh se njerëzit në përgjithësi mbeten në të njëjtat ekspozime pasi trajtohen. Për të zvogëluar sëmundjet dhe kostot e lidhura me to, sektori i shëndetësisë dhe aktorë të tjerë të tjerë përgjegjës për shëndetin dhe mjedisin duhet të pajisen dhe forcohen për të marrë përsipër detyrimet e tyre në formësimin e një të ardhmeje të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Kapaciteti i forcuar i ministrive të shëndetësisë është “çelësi” për të arritur rezultate të përmirësuar shëndetësore, ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre institucionale për të zbatuar një qasje “Shëndeti në të gjitha politikat”. Kjo qasje do të shmangte kostot ekonomike aktuale ose të ardhshme të shkaktuara nga trajtimi i sëmundjeve të lidhura me mjedisin dhe pasojat e tyre, duke lejuar ri-investim në shëndetësi dhe zhvillim të qëndrueshëm.¹⁹

¹⁶ Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Ligji Nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

¹⁷ Kthim përgjigje me email në datë 21.05.2025.

¹⁸ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 42, pika 1.

¹⁹ Strategjia Globale e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Gjatë takimeve me përfaqësuesit e ISHP-së, u deklarua se është e nevojshme një strategji e posaçme për shëndetin mjedisor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucion përgjegjës për përcaktimin, bashkërendimin dhe drejtimin e politikave të shëndetit publik²⁰, nëpërmjet një kthim përgjigje përmend se aktualisht nuk ka asnjë strategji për shëndetin mjedisor²¹.

➤ *Rregullorja e naftës dhe e gazit ka "vakum ligjor".*

Rregullorja e Naftës dhe e Gazit është përgatitur nga Ministria e Industrisë dhe Minierave, në vitin 1976, miratuar me VKM nr.3654, datë 20.12.1976, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1977. Edhe pse rregullorja e sipërcituar është në fuqi, ajo ka humbur rolin e saj, si për efekt të mënyrës së trajtimit të aktivitetëve të naftës dhe gazit, por edhe për shkak të ndryshimit të skemës drejtuese, organizuese e menaxheriale të ndjekjes dhe zbatimit të saj. Institucionet dhe sektorët si: Këshillat Teknikë, Këshillat Shkencorë të Ndërmarrjeve nuk ekzistojnë më. Kështu që, ky akt rregullues është në vakum të plotë, në aspektin praktik të zbatimit të tij. Puna për përgatitjen e draft rregullores së re filloi në vitin 2010 me daljen e Urdhërit nr.540, datë 20.07.2010 të Ministrit të Sektorit Hidrokarbur, me drejtues grupi dy ish zv/ministrat e kohës.

Drafti i përgatitur sipas këtij urdhri është rivlerësuar e ripunuar gjatë periudhës maj-qershor 2014 nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit të Hidrokarbureve, nga ku u hartua edhe drafti final, i cili nuk u miratua asnjëherë.

➤ *Edhe pse kanë kaluar 8 vite nga miratimi i ligjit, MIE nuk ka propozuar ende, pranë Këshillit të Ministrave, krijimin e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve.*

Sipas legjislacionit në fuqi²², Këshilli i Ministrave, me propozimin të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, krijon Institutin Shkencor të Hidrokarbureve, si institucion varësie. Instituti Shkencor i Hidrokarbureve është institucion këshillimor për të gjitha problemet shkencore në fushën e hidrokarbureve. ISHH ka për detyrë kryerjen e studimeve, të analizave, të konsulencës dhe të materialeve opONENTE, të monitorimit, në interes të organeve dhe të institucioneve shtetërore gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në territorin shqiptar, si dhe në sektorët e përpunimit, transportimit, depozitimit e tregtimit të lëndëve e produkteve hidrokarbure.

Grupi i auditimit kërkoi informacion me e-mail pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përse i përket Institutit Shkencor të Hidrokarbureve.

Pavarësisht parashikimeve të Ligjit “Për hidrokarburet” dhe amendimit të vitit 2017, ky Institut nuk është ngritur ende, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

➤ *Inspektorët e mjedisit nuk janë të pajisur me pajisje matëse për të verifikuar zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.*

Në zbatim të Vendimit Nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit” një nga objektivat e qeverisë shqiptare për monitorimin e ajrit është forcimi i kapaciteteve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim matjen e shkarkimeve nga burimet e palëvizshme. Gjithashtu, Plani kombëtar përcakton zonat që do të aplikohet objektivi i qeverisë (zona A dhe zona B²³) si edhe afatin kohor i cili është 2019-2024.

Grupi i auditimit ka konstatuar se inspektorët e mjedisit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk janë të pajisur me pajisje matëse për të bërë të mundur monitorimin e treguesve mjedisor (në ajër, ujë dhe tokë).

2.Gjetje nga auditimi: Ligji “Për hidrokarburet”²⁴ përcakton ndër të tjera krijimin e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve dhe shfuqizimin e dispozitave ligjore që bien në kundërshtim me legjislacionin hidrokarbur. Nga auditimi rezultoi se, edhe pse kanë kaluar 8 vite, Ministria e

²⁰ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 10, pika 2.

²¹ Kthim përgjigje me e-mail në datën 22.04.2025.

²² Ligji nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)*.

²³ Zona A-Tirana dhe Elbasani; Zona B- Fier, Patos etj.

²⁴ Ligji Nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet”²⁴, i përditësuar, neni 13/1.

Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka propozuar ende pranë Këshillit të Ministrave, krijimin e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve. Mosngritja e institucioneve shkencore, në fushën e hidrokarbureve, ka sjellë mungesën e studimeve dhe analizave, gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure në zonat naftëmbajtëse.

3.Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Brendshme²⁵ “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” përcakton se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për hartimin e strategjive, sektoriale dhe ndërsektoriale, që përfshijnë fushat e saj të përgjegjësisë shtetërore. Ministria e Shëndetësisë, si institucion përgjegjës për përcaktimin, bashkërendimin dhe drejtimin e politikave të shëndetit publik, rezulton se nuk ka asnjë strategji për shëndetin mjedisor, pavarësisht rëndësisë së kësaj fushe për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë. Mungesa e një strategjie të qartë e të koordinuar, pengon reagimin e integruar institucional për parandalimin e sëmundjeve të lidhura me faktorët mjedisorë (ajri, uji, mbetjet etj).

2.Konkluzion: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka përmbushur objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e shëndetit publik. Është kufizuar kapaciteti i Ministrisë për të ndjekur, raportuar dhe reaguar ndaj rreziqeve shëndetësore të lidhur me ndotjen mjedisore, çka mund të ndikojë negativisht në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe në kostot afatgjata për sistemin shëndetësor.

2.1.Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për të bërë propozimet pranë Këshillit të Ministrave për ngritjen e Institutit Shkencor të Hidrokarbureve.

Menjëherë

3.1.Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të ndërmarrë nismën për hartimin dhe miratimin e një Strategjie Kombëtare për Shëndetin Mjedisor, në përputhje me legjislacionin vendas dhe angazhimet ndërkombëtare.

Menjëherë

4.2 A po respektojnë kompanitë e shfrytëzimit të naftës dhe gazit, standardet mjedisore për të reduktuar ndotjen?

4.2.1 Si paraqitet gjendja e mjedisit në zonën Patos-Marinëz?

- *Gjendja e mjedisit në zonën naftëmbajtëse nuk është sipas kërkesave të parashikuara në legjislacion.*

Si pasojë e zhvillimeve ekonomike që kanë të bëjnë me shkarkimet e lëndëve të ndryshme ndotëse, “gjendja” e mjedisit shpesh ndikohet ose ndryshohet. Treguesit e gjendjes japin një përshkrim të sasisë dhe cilësisë së dukurive fizike, dukurive biologjike dhe fenomeneve kimike në një zonë të caktuar. Pra, gjendja e mjedisit është kombinimi i kushteve fizike, kimike dhe biologjike, ku përfshihet cilësia e ajrit, cilësia e ujit, cilësia e tokës etj.

Për të krijuar një ide më të qartë mbi gjendjen e mjedisit për zonën, grupi i auditimit ka kryer vizita në terren gjatë fazës studimore dhe fazës së terrenit. Nga verifikimi i kryer në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, gjendja rezulton si më poshtë:²⁶

Gjendja e gropave ekologjike.²⁷

- Gropa ekologjike nr.2 nuk është e rrethuar dhe është e ekspozuar nga hyrja e lirë e njerëzve.
- Gropat ekologjike nuk mbikqyren me personel dhe në momentin e verifikimit nuk kishte asnjë person (roje objekti) prezent;
- Gropat ekologjike nuk kanë stacione të monitorimit të shkarkimeve në ajër etj;

²⁵ Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhërin Nr.178, datë 22.02.2018, Neni 2, pika 4.

²⁶ Akt verifikimi nr.1, datë 08.05.2025, me nr.5824 prot., datë 21.05.2025, protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.



Foto nr.1. Gropa ekologjike nr.2

Foto: Grupi i auditimit

- Hedhja e mbetjeve të rrezikshme (hidrokarbureve) bëhet në mënyrë të çrregullt dhe të ekspozuara jashtë sipërfaqes ujore.



Foto nr.2. Mbetje hidrokarburesh në zonën Zharrëz.

Foto: Grupi i auditimit

- Impiantet e hedhjes së ujit (për amortizimin e ndotjes) në gropat ekologjike nga tetë në total vetën në një prej tyre ishte funksionale.



Foto nr.3. Impjanti i hedhjes së ujit (jo funksional).

Foto: Grupi i auditimit



Foto nr.4. Impjanti i hedhjes së ujit (funksional)

Foto: Grupi i auditimit

Gjendja e puseve të abandonuara dhe puseve aktive:

- Nuk kishte masa rehabilituese dhe territoret përreth tyre, ishin kthyer si pika të grumbullimit të mbetjeve urbane;



Foto nr.5. Mbetje hidrokarburesh së bashku me mbetjet urbane

Foto: Grupi i auditimit

- Këto puse nuk janë të rrethuara;
- Përreth puseve të abandonuara kishte rrjedhje të mbetjeve hidrokarbure të cilat shpërndaheshin deri në afërsi të tokave bujqësore;
- Nuk kanë infrastrukturë informuese ose tabela që tregojnë ndalimin e hyrjes dhe lëvizjes;
- Puset aktive të naftës janë në afërsi të shtëpive të banimit;
- Në afërsi të puseve aktive dhe atyre të abandonuara, vërehen pellgje të ujërave të ndotura dhe në disa zona ka filluar procesi i kënetëzimit;
- Në afërsi të disa puseve aktive zhvillohet aktivitet bujqësor dhe blegtoral.

Para lidhjes së kontratës (para vitit 2004) me subjektin “B. P.” sh.p.k, puset shfrytëzoheshin nga Albpetrol sh.a, ku si fillim nafta bruto e nxjerrë dërgohej në depozitat e grumbullim/dekantimit e më pas në rafineri.

Aktualisht, depot e këtyre stacioneve, janë të sistemit të hapur ose gjysmë të hapur e ku një pjesë e gazit të tretur në naftë gjatë qëndrimit në to, sipas temperaturës, clirohet duke ndotur mjedisin. Po, kështu nga këto depozita shkarkohet një sasi uji në kanalet përreth duke u bërë shkak për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Depozitat e grumbullim/depozitimit të cilat administrohen nga Albpetrol sh.a, janë në afërsi, deri në 30 metra nga

zonat e banuara, kanë rrjedhje, janë të pa rrethuara të cilat ndotin ambjentin dhe krijojnë rrezikshmëri për popullatën.

Grupi i auditimit hartoi disa pyetësor për banorët e zonës në bashkinë Patos dhe Roskovec ku u plotësuan nga 76 banorë. Nga përgjigjet e tyre u evidentua se “*në mjedisin përreth ndjehet erë e rëndë, kjo më e theksuar gjatë orëve të para të mëngjesit dhe të mbrëmjes si dhe uji që furnizohet nga sistemi i ujësjellësit është i ndotur*”.²⁸

➤ *Në zonën Patos-Marinëz nuk ka një stacion të monitorimit të treguesve të mjedisit.*

Referuar Vendimit, Nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit” është parashikuar të shtohet numri i stacioneve të monitorimit, në pikat e nehta mjedisore (zona Patos-Marinëz është cilësuar hotspot mjedisor).

Nga grupi i auditimit u kërkua informacion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për sa i përket stacioneve të monitorimit për treguesit mjedisor në zonën Patos-Marinëz.

Nga auditimi rezultoi se në zonën Patos-Marinëz nuk ka stacione që masin treguesit e gjendjes në mjedis.

➤ *Raportet e gjendjes së mjedisit nuk paraqesin të dhëna për treguesit mjedisor për zonën Patos-Marinëz.*

Shfrytëzimi i nxjerrjes së naftës në zonë shkakton një sërë ndikimesh negative në mjedis dhe shëndetin e komuniteteve. Konkretisht, ndikimet kryesore janë; ndotja e tokës bujqësore nga shpërthimet dhe rrjedhja e puseve, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja e ajrit gjatë procesit të nxjerrjes dhe djegies së naftës nga gazrat që çlirohen si dioksidi i squfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x) dhe grimcat e imta (PM)²⁹.

AKM monitoron treguesit mjedisor, bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, në të cilin përshkruhen dukuritë natyrore të cilësisë së ajrit, ujit, tokës.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit. Ndër funksionet e saj kryesore përfshihet edhe monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së mjedisit, përgatitja dhe publikimi i përvitshëm i RGJM-së, krijimi dhe menaxhimin e informacionit mjedisor dhe sigurimi i informacionit mjedisor për publikun në lidhje me çështjet mjedisore.

Bazuar në VKM-në nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton çdo vit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, (i cili miratohet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit), si mjet i vlerësimit të gjendjes dhe cilësisë së mjedisit në tërësi. Të dhënat e monitorimit pas përpunimit, paraqiten në Raportin e Gjendjes së Mjedisit të vitit respektiv. Monitorimi i treguesve mjedisor kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mbi bazën e përpunimit të rezultateve.

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar programet kombëtare të monitorimit të mjedisit, për periudhën objekt auditimi, ku janë përcaktuar edhe treguesit konkretë që monitorohen për cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës.³⁰

Treguesit konkretë janë pasqyruar në Raportet e Gjendjes së Mjedisit për vitet 2021-2022-2023³¹ të vendosura në dispozicion.

Raporti i Gjendjes në Mjedis i hartuar për çdo vit, paraqet vlerësimin e gjendjes së mjedisit bazuar në të dhënat përkatëse për komponentët kryesorë të tij. Raporti analizon presionet që i bëhen mjedisit të cilat sjellin ndikimet në të, forcat shtytëse që paraqesin burimet e ndotjes si dhe reagimet apo veprimet që duhet të kryhen për të parandaluar forcat shtytëse dhe presionet.

RGJM tregon dhe vlerëson tendencën e treguesve të matur dhe nxjerr në pah problematikat kryesore. Referuar vlerësimit të treguesve jep rekomandime në lidhje me efektivitetin e masave të politikave mjedisore për përmirësimin e gjendjes.

²⁸ Referenca, pyetësorët e kryer tek banorët nga grupi i auditimit (76 persona).

²⁹ Ligji nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

³⁰ Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit 2021-2025.

³¹ Raportet e Gjendjes Mjedisore 2021-2023.

Nga shqyrtimi i RGjM-ve rezulton se nuk ka tregues të gjendjes dhe të ndikimit në mjedis për zonën Patos-Marinëz, zonë nën auditim.

Në mungesë të të dhënave për zonën objekt auditimi, grupi i auditimit po paraqet disa të dhëna, të pasqyruara në RGjM-të e publikuara, për qytetin e Fierit, që është stacioni më i afërt me zonën Patos-Marinëz. Në Raportet e Gjendjes Mjedisore cilësia e ajrit, ujit dhe tokës për basenin e Semanit dhe qytetin e Fierit paraqitet si më poshtë:

- *Cilësia e ujërave sipërfaqësore në lumenj.*

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për parametrat fiziko-kimike duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE (DKU) si dhe legjislacionit në fuqi³².

Tabela 3. Vlerat limite të parametarave kimike në lumenj sipas DKU

	Njësia	Vlerat limite të parametarave kimike				
		Gjendje e Lartë Kl.I	Gjendje e Mirë Kl.II	Gjendje e Moderuar Kl.III	Gjendje e Varfër Kl.IV	Gjendje e Keqe Kl.V
Oksigjen i tretur	mgO/l	>7	>6	>5	>4	>3
NBO ₃	mg/l	<2	<3.5	<7	<18	>18
pH (acid)			>6.5	>6		
pH (alkalin)			<8.5	<9		
NH ₄	mgN/l	<0.05	<0.3	<0.6	<1.5	>1.5
NO ₂	mgN/l	<0.01	<0.06	<0.12	<0.3	>0.3
NO ₂	mgN/l	<0.8	<2	<4	<10	>10
PO ₄	mgP/l	<0.05	<0.10	<0.2	<0.5	>0.5
P-total	mgP/l	<0.1	<0.20	<0.4	<1	>1

Burimi: VKM Nr. 246, datë 30.04.2014.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Fusha naftënxjerrëse në zonën Patos-Marinëz përfshihet në basenin e lumit Seman. Pikat (hot spot) ku merren kampionët dhe kryhen analizat për ujrë sipërfaqësor paraqiten më poshtë: *Koordinatat e stacioneve monitoruese në Basenin Seman (zona nën auditim).*³³

Tabela 4. Stacionet e basenit Seman.

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dv0	Lumi i Semanit	Bilisht – Ura e Treshit	N 40.4101 E 21.0056
2.	Dv1	Lumi i Devollit	Kuçovë – Ura Kuçovë Kozarë	N40.828639 E 19.910801
3.	Os1	Lumi i Osumit	Ura Lapan	N 40.254252 E 20.171348
4.	Os2	Lumi i Osumit	Fshati Uznovë	N 40.689065 E 19.973427
5.	Os3	Lumi i Osumit	Dimal	N 40.774274 E 19.874563
6.	Gj4	Lumi i Gjanicës	Ura e Qytetit Fier	N 40.73383 E 19.572400
7.	Se5	Lumi i Semanit	Ura e Mbrostarit	N 40.750471 E 19.579492
8.	Se6	Lumi i Semanit	Mujalli, Libofshë	N 40.785391 E 19.564659

Burimi: RGjM për vitin 2021.

Përpunoi: Grupi i auditimit


Për basenin e lumit Seman, analizat e ujërave sipërfaqësor kryhen në tetë pika, ku nga këto dy në Lumin Devoll, tre në lumin Osum, një në lumin Gjanicë dhe dy në lumin Seman. Pikat në distancën më të afërt me zonën nën auditim janë, me kod kampionimi, Gj4, Se5 dhe Se6. Vlera e parametarave kimik për vitin 2021 paraqiten si më poshtë:³⁴

³² Vendimi Nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore".

³³ Raporti i Gjendjes Mjedisore 2021.

³⁴ Raporti i Gjendjes në Mjedis 2021.

Grafiku 2. Vlera mesatare O₂ i tretur, mg/l




Burimi: RGjM për vitin 2021.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në stacionin Gj4, që i përket lumit Gjanicë, rezulton me një përmbajtje oksigjeni në vlerën kufi dhe stacionet e tjera klasifikohen në Klasa-I – Gjendje e lartë. Përmbajtja e oksigjenit në vlerat kufi do të kërkojë që Nevoja Biologjike për Oksigjen do të jetë e lartë të cilën e tregon edhe grafiku më poshtë.

Grafiku 3. Vlera mesatare NBO₅, mg/l




Burimi: RGjM për vitin 2021.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Përmbajtja e amonjakut N-NH₄, mg/l, në pikën Gj4 është e lartë dhe klasifikohet në Klasën-V, Gjendje e keqe. Përmbajtja e nitriteve N-NO₂ nitrateve N-NO₃, ortofosfateve P-PO₄, dhe fosforit total janë brenda normave të lejuara.


Grafiku 4. Vlera mesatare N-NH₄, mg/l



Burimi: RGjM për vitin 2021.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku 5. Vlera mesatare N-NO₂, mg/l




Burimi: RGJM për vitin 2021.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Vlera e parametrave kimik për vitin 2022 paraqiten si më poshtë.³⁵

Vlerat mesatare vjetore të treguesve për cilësinë e ujit paraqiten në mënyrë grafike në RGJM e vitit 2022.


Grafiku 6. Vlera mesatare O₂ i tretur, mg/l



Burimi: RGJM për vitin 2022.

Përpunoi: Grupi i auditimit


Grafiku 7. Vlera mesatare NBO₅, mg/l



Burimi: RGJM për vitin 2022.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku 8. Vlera mesatare NH₄ i tretur, mg/l



Burimi: RGJM për vitin 2022.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të publikuara në RGJM për vitet 2018-2021³⁶ dhe 2022-2023 rezulton se Baseni i Semanit për treguesit e ujërave sipërfaqësor, i monitoruar në pikat e përcaktuara në PKMM klasifikohet në Klasën V – gjendje e keqe, ku vetëm për vitin 2023 kemi një përmirësim të treguesve dhe klasifikohet në Klasën IV- gjendje e varfër. Duhet theksuar se monitorimi bëhet larg zonës Patos-Marinëz, por veprimtaria e nxjerrjes së naftës ka ndikim në zonën përreth.

Ndotja më e lartë është në stacionin Gj4- Ura e qytetit të Fierit ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale (që shkarkohen në lumin Gjanica si rezultat i industrisë hidrokarbure) është shumë i madh.

³⁵ Raporti i Gjendjes në Mjedis 2022.

³⁶ Raporti i Gjendjes në Mjedis, viti 2021.

Vlera e parametrave kimik për vitin 2023 paraqiten në formë tabelare si më poshtë:³⁷

Tabela 5. Vlerat mesatare për basenin Seman, 2023

Kodi	Lumi	Vendndodhja	Oksigjeni i tretur, mg/l	pH	NBO5 mg/l	NH4 mg/l	NO2 mg/l	NO3 mg/l	PO4 mg/l	P-total mg/l
Dv0	Seman	Bilisht – Ura e Treshit	11	7.56	5	0.031	0.003	0.3	0.04	0.025
Dv1	Devoll	Kuçovë – Ura Kuçovë Kozarë	9.8	7.71	6	0.077	0.001	0.28	0.008	0.01
Os1	Osum	Ura Lapan	9	7.69	2.5	0.08	0.002	0.23	0.01	0.012
Os2	Osumit	Fshati Uznovë	9.1	7.43	5.5	0.062	0.006	0.23	0.008	0.011
Os3	Osumit	Ura Vajgurore	9.7	7.64	2.5	0.044	0.001	0.2	0.02	0.004
Gj4	Gjanicë	Ura e Qytetit Fier	9.8	7.62	12	0.46	0.005	0.67	0.018	0.021
Se5	Seman	Ura e Mbrostarit	8.5	7.57	4.5	0.23	0.0006	0.38	0.013	0.017
Se6	Seman	Mujalli, Libofsh	7.2	7.6	6	0.077	0.0028	0.26	0.016	0.021

Burimi: RGJM për vitin 2023.

Përpunoi: Grupi i auditimit

• Cilësia e ajrit.

Në zonën e Fierit, të dhënat tregojnë probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës. Në kuadër të projektit G.-A., të financuar nga A.. K. S. për B. dhe Zh. (S.), për vitet 2022-2023, është monitoruar gjendja e mjedisit në zonën naftëmbajtëse që është në administrimin e Bashkisë Patos dhe afër industrisë së përpunimit të naftës. Referuar raportit të vitit 2022, parametrat e cilësisë së ajrit janë matur në katër pika Hot-spote; pranë Qendrës në Mallakastër, si pikë referuese e banuar; pranë rrugës “Aranitas”, si pikë pranë rafinerisë së naftës (Bashkia Mallakastër); pranë gropave ekologjike, T..S.. dhe pranë gropave ekologjike, Kanali i Hoxharës në zonën e Marinzës.

Gropat ekologjike janë vende të përcaktuara ku hidhen mbetjet hidrokarbure, si materiale të rrezikshme të dala gjatë nxjerrjes së naftës³⁸.

Tabela 6- Parametrat e cilësisë së ajrit pranë rrugës Terraoil-Swiss dhe pranë rrugës “Kanali i Hoxharës” (në ppm)³⁹

Parametri	VOC	O ₃	SO ₂	CO	CO ₂	PM _{2.5}	PM ₁₀	NO ₂
Vlera min.	850.1	0.008	0.000	0.0	374	0.007	0.009	0.072
Vlera maks.	1510.9	0.020	0.000	0.0	374	0.008	0.032	0.065
Vlera mes.	1103.4	0.014	0.000	0.0	374	0.007	0.015	0.071
Parametri sipas standarteve të BE (ppm 24h)	n/a	0.060	0.040	4	n/a	0.015	0.040	0.025
Parametri sipas standarteve të EHO (ppm 24h)	n/a	0.120	0.125	10	n/a	0.025	0.050	0.050

Burimi: Vlerësimi Mjedisor i Zonës Naftëmbajtëse Patos-Marinëz, Projekti Green-Al, 2022.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në vlerësimin mjedisor të kryer nga Projekti G.-A. theksohet se, matjet janë bërë në muajt me shumë reshje, të cilat ndikojnë në rilevimin e parametrave të monitoruar. Nga parametrat e matur rezulton se cilësia e ajrit në zonën e ndikuar nga industria e nxjerrjes së hidrokarbureve është jashtë parametrave të lejuar nga BE dhe kuadri ligjor për shkak të përmbajtjes së lartë të NO₂ dhe gazrave të tjerë. Si rrjedhojë edhe vlerat e VOC janë jashtë parametrave të lejuara, të cilat janë si rezultat i vlerave të larta të NO₂ të cilat hyjnë në reaksion me elementë ndotës të tjerë të ajrit në zonë.

-Në PKMM përcaktohen treguesit mjedisor të gjendjes si dhe shpeshësia e tyre se kur dhe si duhet të maten treguesit si: përmbajtja e O₃ në ajër, përmbajtja e Pb, përmbajtja e SO₂, përmbajtja e NOX, përmbajtja e CO, përmbajtja e PM₁₀, PM_{2.5}.

Nga shqyrtimi i RGJM-ve për vitet 2012-2023 rezulton se stacioni (që mat cilësinë e ajrit urban), më i afërt me zonën Patos-Marinëz ku shfrytëzohet nxjerrja e naftës, është në qytetin e Fierit, në oborrin e shkollës “Janaq Kilica” dhe mat vetëm treguesit SO₂ dhe O₃. Për vitin

³⁷ Raporti i Gjendjes në Mjedis, viti 2023.

³⁸ <https://youtu.be/MÉmrNdaAuEM?si=QStHBfuqvEEqUDA4>

³⁹ Vlerësimi Mjedisor i Zonës Naftëmbajtëse Patos-Marinëz, P. G.-A. (financuar S.), 2022, vendosur në dispozicion nga Bashkia Patos.

2021 janë paraqitur sasia SO₂ dhe O₃ të cilat janë brenda vlerave të lejuara, viti 2022 nuk ka vlera të pasqyruara në RGJM.

- *Cilësia e tokës*

Planet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit përcaktojnë edhe treguesit mjedisor të gjendjes që vijnë nga burime të fuqishme të ndotjes industriale, monitorimin e treguesve si: sipërfaqja dhe lokalizimi i tokave të ndotura me hidrokarbure. Sipas PKMM, për këto toka të identifikuar përcaktohet që analizat të kryhen 1 herë në 2 vjet, si dhe ndërtimi i hartave me shkallë të ndryshme në bazë të të dhënave të fituara. Zona ku kryhet aktiviteti i nxjerrjes së naftës në Shqipëri është përcaktuar si një pikë e nxehtë mjedisore⁴⁰ ku në përshkrimin e gjendjes citohet: *“Në zonën e Patos-Marinzës ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor ndoten seriozisht nga pusët e naftës, gjatë nxjerrjes me pompa, nga tubacionet dhe impiantet e para trajtimit dhe në ajër shkarkohet gazi sulfurik dhe hidrokarbure të ndryshme. Ujërat e përdorur nga këto impiante shkarkohen në lumin Gjanicë, ku përvec përbërësve të naftës kanë edhe lëndë toksike”*.

Treguesit mjedisor të pasqyruar në RGJM janë të fragmentarizuar dhe me cilësi jo shumë të mirë të të dhënave të monitorimit, të cilat ndikojnë në cilësinë e të dhënave dhe performancën e tyre. Në RGJM, nuk ka një panoramë të plotë të të dhënave mjedisore të mbledhura nga ana e gjithë institucioneve monitoruese në vend, në lidhje me llojin e informacionit dhe të dhënave të disponueshme mjedisore nga secili prej tyre si dhe mbulimit gjeografik. Ndërtimi i një panorame të tillë, është një nga prioritetet e sotme si dhe një nga orientimet kryesore të bëra nga programet e asistencave të huaja, që kanë vepruar e vazhdojnë ta bëjnë këtë gjë në Shqipëri. Proceset e tenderimit të aktiviteteve monitoruese vjetore, bazuar në specifikime teknike të përgatitura mirë, duke nënvizuar qartësisht edhe kërkesat ndaj kontraktuesve, me qëllim shmangien e mangësive të mësipërme të evidentuara, do të ndihmonin në sigurimin e vazhdimësisë dhe koherencës së proceseve monitoruese, edhe në rastet kur mund të ndryshojnë, kontraktorët e aktiviteteve monitoruese.

- *MTM nuk siguron informacion në kohë reale për publikun në zonën Patos-Marinzë, në rast të kapërcimit të parametrave ndotës.*

Sipas legjislacionit në fuqi, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të sigurojë informacion në kohë për publikun mbi kapërcimet aktuale apo të parashikuara të çdo pragu të alarmit dhe të informacionit. Informacioni për përqendrimet në mjedis të dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit, lëndës së ngurtë pezull (të paktën PM10), ozonit dhe monoksidit të karbonit duhet të përditësohet të paktën çdo ditë dhe kur është e mundur, informacioni duhet të përditësohet çdo orë. Informacioni për përqendrimet në mjedis të plumbit dhe benzenit, paraqitur si vlerë mesatare për 12 muajt e fundit, duhet të përditësohet çdo tre muaj dhe, kur është e mundur, çdo muaj.

Aksesi i publikut në informacionin mjedisor, përgjegjësitë e autoriteteve përkatëse publike për të respektuar këtë të drejtë, si në aspektin e afateve, formës dhe përmbajtjes, gjithashtu dhe mënyra e dhënies së informacionit, garantohet nga legjislacioni në fuqi⁴¹ i cili është në përputhje me Konventën e Aarhusit dhe Direktiva 2003/4/EC.

Dhënia e Informacionit Mjedisor është një detyrim ligjor që buron nga Konventa e Aarhusit dhe ratifikuar nga Shqipëria që në vitin 2000 dhe është pasqyruar në të gjithë legjislacionin mjedisor.

Informimi i publikut do të jetë i suksesshëm nëse ai nuk konsiderohet thjesht si destinacion i emëtimit të informacionit, por si një aktor veprues për të frenuar pasojat e raportuara në Raport. Çdo individ ka nevojë të dijë çfarë kimikate çlirohen nga industria e nxjerrjes së naftës, ndotja që ato shkaktojnë në mjedis si dhe pasojat në jetën e publikut. Gjithashtu, në informim duhet të jetë edhe ofrimi i masave parandaluese si një formë tjetër e efektshme për të arritur gjithnjë e më shumë publikun, pasi individit i janë ofruar zgjidhje dhe është i

⁴⁰ Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve të Integruara 2020-2035.

⁴¹ Ligji Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”, neni 46; VKM nr. 16, datë 4.1.2012 “Për të drejtën e aksesit të publikut në informacionin mjedisor”.

sensibilizuar e në këto kushte mund të kthehet në llogari-kërkues aktiv. Shkaktarët e ndotjes së mjedisit duhet të jenë përcaktuar drejt së bashku me rreziqet potenciale për secilin ndotës. Grupi i auditimit ju drejtua me pyetësor Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe me email, datë 28.04.2025. MTM konfirmoi se nuk ka një sistem informimi në rast të kapërcimit të parametrave ndotës, konkretisht për hot-spotin Patos-Marinëz.

-Situatat emergjente teknologjike (industriale) mund të vijnë nga shkaqe të ndryshme në objektet industriale, si për shembull: depozita të karburanteve dhe të materialeve të rrezikshme, në tubacione ose në instalime të ndryshme, në komplekse industriale ku përdoren lëndë të cilat, në gjendje të lirë ose në kombinim me njëra-tjetrën, mund të shkaktojnë zjarre, ndotje, shpërthime etj.

Risqet teknologjike janë shqetësime për emergjencat mjedisore dhe për emergjencat e mundshme civile.⁴²

Për sa më lart, duke mos u informuar publiku për kapërcimin e parametrave ndotës në zonën Patos-Marinëz është e pamundur të merren masa në rast të situatave emergjente, të përcaktuara në kuadrin rregullator.

4.Gjetje nga auditimi: Gropat ekologjike në të cilat depozitohen mbetje të rrezikshme të dala nga veprimtaria e nxjerrjes së naftës, duhet të plotësojnë kriteret e sakta teknike dhe operacionale. Nga verifikimi në terren i gjendjes mjedisore rezultoi se, gropat ekologjike nuk janë të mbikëqyrura me personel dhe nuk kanë infrastrukturë informuese. Ato nuk kanë sistem të monitorimit të shkarkimeve në ajër, sipas të cilave duhet të merren masat paraprake dhe parandaluese për mbrojtjen e popullatës. Gropa ekologjike nr.2⁴³ është e pa rrethuar dhe e ekspozuar nga hyrja e lirë e njerëzve dhe kafshëve ku përbën një rrezik të lartë për zonën përreth. Në zonë ndjehet erë e rëndë në orët e para të mëngjesit dhe në mbrëmje, e cila vjen si rezultat i mosfunksionimit të impianteve të hedhjes së ujit, të cilat reduktojnë kimikatet që çlirohen gjatë proceseve të nxjerrjes së naftës. Puset e abandonuara janë të pa rrethuar dhe rreth tyre ka pellgje uji të ndotura dhe pa infrastrukturë informuese. Gjithashtu, depot e grumbullim/depozitimit të përdorura dhe që janë në administrim nga Albpetrol sh.a, janë në afërsi të zonave të banuara, kanë rrjedhje të mbetjeve të rrezikshme të naftës, janë të pa rrethuara, duke ndotur ambientin dhe krijuar rrezikshmëri për popullatën.

5.Gjetje nga auditimi: Zona Patos-Marinëz është klasifikuar hotspot mjedisor dhe si e tillë duhet të ketë një stacion të monitorimit të treguesve të mjedisit. Nga auditimi rezultoi se, në zonën Patos-Marinëz nuk ka stacione që masin treguesit e gjendjes në mjedis, e për rrjedhojë nuk ka një sistem online për informimin e publikut, në rastet të kapërcimit të treguesve mjedisorë, në këtë zonë, për parametrat e dyoksidit të squfurit, dyoksidit e azotit, lëndës së ngurtë pezull (të paktën PM10), ozonit dhe monoksidit të karbonit.

6.Gjetje nga auditimi: Programet kombëtare të monitorimit të mjedisit, përcaktojnë treguesit konkretë që duhet të monitorohen në një zonë si: cilësia e ajrit, uji dhe tokës. Nga auditimi i Raporteve të Gjendjes në Mjedis të hartuara çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mbi bazën e treguesve mjedisorë të grumbulluar rezultoi se, në këto raporte nuk ka të dhëna për zonën Patos-Marinëz, mbi të cilin klasifikohen treguesit mjedisorë. Mungesa e treguesve për zona të përcaktuara si hot-spote mjedisore i bën raportet të cunguar sa i takon shkallës së përfaqësimit të gjithë treguesve mjedisorë të aplikuar gjerësisht. Gjithashtu, mungesa e të dhënave e bën të vështirë lidhjen midis gjetjeve të Raporteve të Gjendjes së Mjedisit dhe politikave mjedisore kombëtare, e kështu raporti nuk përmbush misionin e tij dhe informacioni i ofruar për publikun nuk është i plotë e i kuptueshëm.

3.Konkluzion:

-Monitorimi i dobët, nga ana e AKM dhe Albpetrol sh.a, i gjendjes faktike në mjedisin përreth gropave ekologjike dhe puseve të abandonuara, ka sjellë ndotje të ajrit, ujrave dhe tokës.

⁴² Vendim nr. 807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile".

⁴³ Gropa ekologjike nr.2 me koordinata X:4387236; Y:4509867.

-Mungesa e stacioneve të monitorimit të treguesve të ajrit, ujit dhe tokës në zonën Patos-Marinëz i bën këto raporte me mangësi të theksuara për zonën.

-Mungesa e një sistemi informimi për treguesit mjedisorë në kohë reale nuk realizon marrjen e masave në rast të situatave emergjente.

4.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që subjektet naftënxjerrëse të kryejnë rrethimin e gropave ekologjike, puseve të abandonuara dhe depove të grumbullim/dekantimit, vendosjen e infrastrukturës informuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të kryejë inspektime për impiantet e hedhjes së ujit, që të jenë gjatë gjithë kohës funksional dhe subjektet naftënxjerrëse të vendosin stacione të monitorimit të ajrit duke raportuar në kohë reale parametrat.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Rekomandim: Ministria e Mjedisit të marrë masa për vendosjen e një stacioni të matjes së të gjithë parametrave mjedisor në zonën Patos-Marinëz dhe të informojë publikun në rast të kapërcimit të normave të lejuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të komponentëve mjedisorë në zonën Patos-Marinëz, ti unifikojë ato, të kryejë analiza e vlerësime mjedisore për përcaktimin e prirjeve në vite dhe parashikimin e prirjeve mjedisore për të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.2 A është garantuar nga institucionet përgjegjëse monitorimi, inspektimi, raportimi i treguesve mjedisore lidhur me aktivitetin e shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz?

- *Bashkia Roskovec nuk ka verifikuar subjektet e nxjerrjes së naftës që operojnë në juridiksionin e saj.*

Ligji “Për Vetëqeverisjen vendore” krahas organizimit të njësive të vetëqeverisjes vendore përcakton edhe funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit.⁴⁴ Një nga parimet kryesore është sigurimi në nivel vendor i masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja. Nga auditimi është konstatuar se Bashkia Roskovec nuk ka verifikuar asnjë nga subjektet e nxjerrjes së naftës dhe gazit që operojnë në juridiksionin e saj. Në vitin 2024, bashkisë Roskovec i ka ardhur një ankesë nga banorët, të cilët pretendojnë se “*pranë gropës ekologjike nr.7, e menaxhuar nga subjekti “B. P.”sh.p.k shkarkohen mbetje gazi të rrezikshme*”. Këtë ankesë të qytetarëve, njësia vendore Roskovec e ka deleguar pranë subjektit “B. P.”sh.p.k.

Ndërsa, bashkia Patos ka kryer verifikime në terren në subjektet naftënxjerrëse, të inicuar nga ankesat e ardhura nga banorët e zonës. Në akt verifikimet e mbajtura nga NJQV Patos përshkruhet se “*subjektet e mësipërme (Albpetrol sh.a dhe B.. P.. sh.p.k) kanë ndotur mjedisin dhe tokën bujqësore, si dhe kanë kryer bllokim të kanaleve kulluese*”.

Pas mbajtjes së akt verifikimeve, bashkia Patos iu ka nisur shkresë subjekteve Albpetrol sh.a dhe B. P. sh.p.k për marrjen e masave të menjëhershme.

Grupi i auditimit konstatoi se bashkia Patos nuk ka kryer më ri-verifikime në terren për zbatimin e detyrave të lëna, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e situatës.

- *Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk ka kryer mbikëqyrje të plotë për subjektet hidrokarbure.*

⁴⁴ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 26, pika 1.

Referuar Vendimit “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”⁴⁵, AKBN-ja mbikqyr veprimtarinë hidrokarbure. Sipas “Përshkrimit të punës të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, Sektori i Mbikqyrjes së Ndikimit në Mjedis të Veprimtarisë Hidrokarbure (sektor pranë Drejtorisë së Hidrokarbureve) ka përgjegjësi mbikqyrjen, kontrollin, inspektimin dhe zbatimin e detyrimeve kontraktore të Licensë-Marrëveshjeve dhe Marrëveshjeve Hidrokarbure, në lidhje me Ndikimin në Mjedis. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Hidrokarbureve ka kryer 6 verifikime gjatë periudhës 2021-2024. Akt verifikimet e mbajtura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk përshkruajnë zbatimin e detyrimeve kontraktore të Licensë-Marrëveshjes, për sa i përket Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Tabela nr.7

Nr.rendor	Subjekti	Data e verifikimit	Cështja e verifikimit
1.	Albpetrol sh.a	23.05.2024	Plani i abandonimit
2.	Albpetrol sh.a	12.04.2024	Plani i abandonimit
3.	B.. P.. sh.p.k	24.05.2022	Verifikim fizik të gjendjes së materialeve stok
4.	B.. P.. sh.p.k	29.06.2022-01.07.2022	Operacione hidrokarbure
5.	B.. P.. sh.p.k	08.03.2022-11.03.2022	Operacione hidrokarbure
6.	B.. P.. sh.p.k	28.03.2023-30.03.2023	Shlyerjen e detyrimeve kontraktore

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Përpunoi: Grupi i Auditimit

➤ Akt verifikimet e mbajtura nga AKBN-ja nuk janë të prokolluara.

Sipas legjislacionit në fuqi, dokumentet e brendshme, si: raportet, relacionet, informacionet, duhet të kenë të gjithë elementët si data dhe numri i protokollit. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar.⁴⁶

Grupi i auditimit ka shqyrtuar akt verifikimet e mbajtura nga AKBN-ja dhe ka rezultuar se janë pa numër protokollit si dhe nuk janë paraqitur Drejtorit Ekzekutiv për njohje dhe firmë.

➤ Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer ri-inspektime për korrigjimin e shkeljeve.

Gjatë periudhës objekt auditimi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë kanë kryer 16 procedura inspektimi në subjektet e nxjerrjes së naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz.

Më poshtë po paraqesim në formë tabelare inspektimet e kryera dhe masat e marra nga trupa inspektuese.

Tabela nr.8

Nr. rendor	Subjekti	Data	Vendimi përfundimtar	Shkeljet sipas legjislacionit mjedisor
1.	Albpetrol sh.a	3/10/2024	Gjobë 300000 Lekë	Mospërbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B
2.	B.. P..A.. sh.p.k	3/09/2024	Gjobë 500000 Lekë	Mospërbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A apo B nga operatori i një instalimi
3.	B.. P.. A.. sh.p.k	27/08/2021	Gjobë 1000000 Lekë	"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
4.	B...P.. A.. sh.p.k	5/11/2021	Nuk ka masë administrative	Nuk ka shkelje.
5.	B.. P.. A.. sh.p.k	8/10/2024	Gjobë 1300000 Lekë	"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
6.	B.. P.. A.. sh.p.k	1/03/2023	Gjobë 1000000 Lekë	"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
7.	Albpetrol sh.a	29/02/2024	Gjobë 500000 Lekë	"Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
8.	Albpetrol sh.a	03/10/2023	Gjobë 300000 Lekë	Mospërbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B.
9.	Albpetrol sh.a	7/10/2022	Gjobë 500000 Lekë	Ligji "Për Trajtimin Mjedisor të ujërave të Ndotura"

⁴⁵ Vendim nr.547, datë 09.08.2006 i përditësuar, pika 3.

⁴⁶ Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, Neni 13.

10.	B.. P.. A.. sh.p.k	14/09/2021	Gjobë 500000 Lekë	Ligji nr.10448, datë 14.07.2011.
11.	Albpetrol sh.a	04/12/2023	Gjobë 1000000 lekë	Ligji “Për lejet e Mjedisit” i ndryshuar neni 29.
12.	Albpetrol sh.a	26/10/2023	Gjobë 5000000 lekë	Ligji “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. neni 30.
13.	Albpetrol sh.a	04/10/2023	Gjobë 1000000 lekë	Ligji “Për lejet e Mjedisit”i ndryshuar, neni 29.
14.	Albpetrol sh.a	24/12/2021	Gjobë 500000 lekë	Ligji “Për Trajtimin Mjedisor të ujërave të Ndotura”, neni 23, pika 2.
15.	Albpetrol sh.a	24/12/2021	Gjobë 1000000 lekë Gjobë 1000000 lekë	-Ligji “Për lejet e mjedisit” neni 29, b, gërma i, -Ligji “Për lejet e mjedisit” neni 29, pika b, gërma i.
16.	B.. P.. sh.p.k.	14/11/2024	Gjobë 500000 lekë	Ligji “Për lejet e mjedisit” neni 29, pika b, gërma ii

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Përpunoi: Grupi i auditimit.

Drejtoria e Inspektim-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë janë përgjegjëse për inspektimin e kushteve të lejes së mjedisit në instalimet e tipit A dhe B. Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.⁴⁷

Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri nga njësia inspektuese pranë AKM/ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë.

Grupi i auditimit ka shqyrtuar vendimet përfundimtare të inspektimit⁴⁸ dhe ka evidentuar subjektet e nxjerrjes së naftës, që janë urdhëruar që të korrigjojnë shkeljet, (tabela e mëposhtme). Për sa më sipër, nga trupa inspektuese nuk janë kryer më ri-inspektime për të verifikuar zbatimin e detyrave të lëna.

Tabela nr.9

Nr. rendor	Subjekti	Vendimi Përfundimtar	Ri-inspektime
1.	Albpetrol sh.a	03.10.2024	Nuk ka.
2.	Albpetrol sh.a	29.02.2024	Nuk ka.
3.	Albpetrol sh.a	03.10.2023	Nuk ka.
4.	Albpetrol sh.a	07.12.2022	Nuk ka.

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Përpunoi: Grupi i Auditimit.

- Sipas procesverbaleve të mbajtura nga inspektorët, nuk janë marrë asnjëherë mostrat e substancave.

Sipas ligjit “Për inspektimin”, inspektorët kanë të drejtë të marrin, pa pagesë, mostra të produkteve, materialeve, substancave apo prodhimeve dhe t’ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Mostrat merren në prani të përfaqësuesit të subjektit të inspektuar. Marrja e mostrave pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Inspektori është i detyruar të njoftojë rezultatet e ekspertizës apo të ekzaminimit brenda 4 ditëve nga data e marrjes së rezultatit të tyre.⁴⁹

Grupi i auditimit ka shqyrtuar procesverbalet e mbajtura nga inspektorët e mjedisit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe ka rezultuar se përgjatë viteve objekt auditimi nuk janë marrë asnjëherë mostra të produkteve, substancave me qëllim që tui nënshtrohen ekzaminimit apo analizave të mëtejshme.

Tabela nr.10.

Nr. rendor	Subjekti	Vendimi Përfundimtar	Marrja e mostrave	Nr.i çështjes
1.	B.. P.. sh.p.k	04.10.2021	Nuk ka.	Nr. AKM-FR-2021-000185 - 2

⁴⁷ Ligji nr. 10 443, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 48, pika 4 dhe 5.

⁴⁸ Dokumentacion i vendosur në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me CD.

⁴⁹ Ligji nr. 10 443, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 38.

2.	B.. P.. sh.p.k	10.09.2024	Nuk ka.	Nr. AKM-FR-2024-000173 - 2
3.	B.. P.. sh.p.k	16.02.2023	Nuk ka.	Nr. AKM-FR-2023-000004 - 2
4.	Albpetrol sh.a	04.09.2024	Nuk ka.	Nr. AKM-FR-2024-000168 - 2
5.	Albpetrol sh.a	04.09.2023	Nuk ka	Nr. AKM-FR-2023-000109 - 2
6.	B.. P.. sh.p.k	20.08.2021	Nuk ka	Nr. AKM-FR-2021-000131 - 2
7.	B.. P.. sh.p.k	07.08.2024	Nuk ka	Nr. AKM-FR-2024-000148 - 2
8.	B.. P.. sh.p.k	27.07.2021	Nuk ka	Nr. AKM-FR-2021-000101 - 2

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Përpunoi: Grupi i Auditimit

- *Komisioni i shqyrtimit të ankimeve është mbledhur tej afatit dhe ka shfuqizuar vendimin e dënimit për subjektin Albpetrol sh.a.*

Pas vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti mund të ankimojë vendimin brenda 30 ditëve pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është Sektori i Ankimeve (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i penalteteve), që ka detyrë si fushë të veprimtarisë së tij shqyrtimin e ankimeve për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve.

Referuar Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ që zgjidh ankimin nxirret dhe i njoftohet palës brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit.

Nga databaza e vendosur në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, grupi i auditimit ka identifikuar një rast⁵⁰, kur Komisioni i Ankimeve pranë AKM-së është mbledhur tej afateve të përcaktuara dhe ka vendosur shfuqizimin e gjobës për subjektin Albpetrol sh.a. sh.a.

- *Subjekti Albpetrol sh.a nuk ka dorëzuar raportet e vetmonitorimit.*

Operatori i veprimtarive hidrokarbure monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit. Subjekti pasi pajiset me leje mjedisi përkatëse monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara. Rezultatet e vetëmonitorimit dorëzohen pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, cdo 3 muaj (për lejet e mjedisit Tipi A) dhe cdo 6 muaj (për lejet e mjedisit Tipi B).

Nga auditimi rezultoi se subjekti Albpetrol sh.a (nr.i lejes PN-6.-0.-2...) me aktivitet nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror, me vendndodhje rruga “Fier-Patos”, km.8, nuk ka dorëzuar raportet e vetmonitorimit për zbatimin e kushteve të lejes pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për periudhën 2021-2023.

- *Raportet e vetmonitorimit pasqyrojnë se subjektet naftënxjerrëse nuk ndotin mjedisin..*

Grupi i auditimit ka shqyrtuar raportet e vetmonitorimit të subjekteve B.. P.. sh.p.k dhe Albpetrol sh.a (për vitin 2024). Në raportet e dorëzuara nga subjektet e mësipërme pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për treguesit si: shkarkimet në ajër, emëtimi i metaleve të rënda në ajër, emëtimet nga inceneratorët dhe gjenerimi i zhurmave, përshkruhet se këto tregues janë brenda normave të lejuara. Theksojmë se, sipas legjislacionit mjedisor, raportet e vetmonitorimit të operatorëve që janë të pajisur me leje mjedisi, kryhen nga subjekte private.

- *Subjekjet e nxjerrjes së naftës në Patos-Marinëz nuk kanë dorëzuar cdo transfertë të mbetjeve të rrezikshme nëpërmjet sistemit e-Albania.*

Vendimi nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” miraton rregullat për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre, nga një person tek një tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Përpara largimit të mbetjeve të rrezikshme nga vendi ku gjenerohet/gjenerohen, dorëzuesi i tyre duhet të plotësojë dokumentin e dorëzimit në aq kopje sa janë personat që e nënshkruajnë atë. Dokumenti i dorëzimit plotësohet dhe nënshkruhet nga dorëzuesi, transportuesi dhe marrësi i mbetjeve të rrezikshme. Dorëzuesi, për çdo transfertë, u dërgon nga një kopje elektronike, nëpërmjet portalit e-Albania, të

⁵⁰ Subjekti A..sh.a ka bërë ankim administrativ pranë AKM-së në datë 31.10.2024. AKM ka vendosur për shfuqizimin e gjobës në datë 03.12.2024.

dokumenteve të dorëzimit, të plotësuar e të nënshkruar nga palët, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Nga auditimi rezultoi se asnjë nga subjektet naftënxjerrëse (subjektet Albpetrol sh.a dhe B.. P.. sh.p.k) në zonën Patos-Marinëz nuk ka raportuar për cdo transfertë të kryer të mbetjeve të rrezikshme, nëpërmjet portalit e-Albania. Po kështu, Albpetrol sh.a nuk ka dorëzuar regjistrin e mbetjeve të rrezikshme (cdo 6 muaj) as në formë fizike pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

➤ *86.5 mijë ton mbetje prej vitesh, të mbetura pezull për asgjësim.*

Referuar Ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me parimin “Ndotësi paguan”, mbulohen nga krijuesi fillestar i mbetjeve ose nga zotëruesi aktual apo i mëparshëm i tyre.

Nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore kanë mbajtur një relacion⁵¹ në subjektin B.. P.. sh.p.k dhe kanë konstatuar se në territorin e kësaj të fundit janë 86.5 mijë ton mbetje të gjeneruara nga aktiviteti hidrokarbur. Në akt verifikim përshkruhet se “*subjekti B.. P.. sh.p.k ka pretenduar se mbetjet janë të trashëguara nga “Albpetrol sh.a”.*

Gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit i ka dërguar një pyetësor AKBN-së, për sa i përket situatës së mbetjeve në territorin e subjektit B.. P.. sh.p.k. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore citon se “*Mosmarrëveshja qëndron në faktin se cili prej kompanive do t’i trajtojë B.. P.. sh.p.k apo Albpetrol sh.a”.*

➤ *2 gropa ekologjike nuk janë të pajisura me leje mjedisi.*

Sipas legjislacionit në fuqi, subjekti duhet të pajiset me leje mjedisi për aktivitetin që ushtron. Kërkuuesi që aplikon pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për pajisjen me leje mjedisi të Tipit A/B, duhet të dorëzojë dokumentat: formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A/B; mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit; cdo informacion tjetër që kërkuuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit; kopjen e vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis; raportin mbi sigurinë; relacion rreth dëgjësës me publikun. AKM-ja, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit A/B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e tjera, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit A/B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit A/B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti të shoqëruar me argumentet përkatëse.⁵²

Subjekti B.. P.. sh.p.k dhe Albpetrol sh.a janë të pajisura me lejet e mjedisit si më poshtë:⁵³

Tabela nr.11

Nr. rendor	Subjekti	Leja e mjedisit	LC	Leje mjedisi
1.	Albpetrol sh.a	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror	LC-889.	Leje Tipi A
2.	B.. P.. sh.p.k	Magazinin i naftës dhe i nënprodukteve të saj në cistern të palëvizshme në një terminal	LC-274.	Leje Tipi B
3.	B.. P.. sh.p.k	Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme përveç incenerimit ose landfillit	LC-905.	Leje Tipi B
4.	B.. P.. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme (Gropa ekologjike nr.8)	LC-003.	Leje Tipi B
5.	B.. P.. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme (Gropa ekologjike nr.3)	LC-003.	Leje Tipi B
6.	B.. P.. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme (Gropa ekologjike nr.4)	LC-003.	Leje Tipi B

⁵¹ Relacion i mbajtur në datë 14.01.2025.

⁵² VKM Nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”i përditësuar, kreu II , III.

⁵³ Edhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore cilëson se zonën Patos-Marinëz janë 8 gropa ekologjike.

7.	B.. P.. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme (Gropa ekologjike nr.7)	LC-026.	Leje Tipi B
8.	B.. P.. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme (Gropa ekologjike nr.5)	LC-026.	Leje Tipi B
9.	B.. P.. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme (Gropa ekologjike nr.6)	LC-026.	Leje Tipi B
10.	B.. P.. sh.p.k	Trajtimi i ujërave të ndotura industrial	LC-359.	Leje Tipi B
11.	B.. P.. sh.p.k	Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi.	LC-325.	Leje Tipi B
12.	B.. P.. sh.p.k	Kërkim i naftës dhe gazit natyror.	LC-448.	Leje Tipi A
13.	B.. P.. sh.p.k	Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror.	LC-448.	Leje Tipi A

Burimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Nga kthimi i përgjigjes nga bashkia Roskovec dhe bashkia Patos, në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz⁵⁴ ka 8 gropa ekologjike. Grupi i auditimit ka kërkuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, lejet e mjedisit për subjektet Albpetrol sh.a sh.a dhe B.. P.. sh.p.k (pasqyruar në tabelën e mësipërme). Nga shqyrtimi i lejeve të mjedisit ka rezultuar se dy gropa ekologjike (pjesë të Albpetrol sh.a) që ndodhen në hot-spotin mjedisor Patos-Marinëz nuk janë të pajisura me leje mjedisi.

- *Kushtet e lejeve të mjedisit për gropat ekologjike përcaktojnë se mbetjet duhet të ruhen me një afat të pacaktuar.*

Ligji nr.10.443, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, përkufizon ndër të tjera edhe termin “ruajtje e përkohshme” që nënkupton mbajtjen në një vend, me qëllim ruajtjen e mbetjeve për një periudhë kohe jo më shumë se një vit, pa kryer operacione që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së mbetjeve. Subjekti duhet të marrë masa për t’i grumbulluar, transportuar, magazinuar dhe trajtuar mbetjet, vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Në rast të kundërt, përbën kundravajtje administrative.

Grupi i auditimit shqyrtoi kushtet e lejes së mjedisit (për subjektin B.. P.. sh.p.k) për aktivitetin “stacione të transferimit të mbetjeve të rrezikshme”(gropa ekologjike), që janë miratuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit (pas hartimit të aktit të miratimit nga AKM). Nga auditimi rezultoi se një nga kushtet e lejes së mjedisit është: “*materiali i depozituar në këto gropa do të ruhet aty për një kohë të pacaktuar derisa të fillojë punë impianti i trajtimit të këtyre mbetjeve , të cilin B.. P.. sh.p.k është duke e ndërtuar*”. Lejet e mjedisit për gropat ekologjike janë miratuar në muajin janar 2024. Pasi subjekti “B.. P..” sh.p.k është pajisur me leje mjedisi për 6 gropa ekologjike ka bërë kërkesë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për heqje dore nga lejet e mjedisit (me format të vjetër, të miratuara në vitin 2011).

Në vijim, grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nëse impianti i trajtimit të mbetjeve të subjektit B..P.. sh.p.k ka filluar të funksionojë. Nëpërmjet një përgjigjeje me email, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore citon se “*impianti i trajtimit të mbetjeve nuk është vendosur ende në funksionim*”. Kështu që, mbetjet po ruhen në gropat ekologjike tej afatit ligjor (kuadri ligjor përcakton ruajtjen e mbetjeve jo më shumë se 1 vit).

- *Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk kthen përgjigje për publikimin në mediat vizive të dëgjesave me publikun.*

Referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, subjekti përpara aplikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t’u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin për të paktën

20 (njëzet) ditë kalendarike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.

Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjese me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të. Njoftimi për dëgjесën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve: në radio ose TV dhe gazetën vendore.⁵⁵

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për njoftimet për dëgjesat me publikun (që duhet të jenë pjesë e dosjes), që kanë realizuar subjektet naftënxjerrëse në zonën Patos-Marinëz. Edhe pse ka kaluar afati i kthim përgjigjes, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, nuk kemi ende një kthim përgjigje (mohuese/pohuese).

7.Gjetje nga auditimi: Ligji “Për inspektimin” përcakton parimet bazë të inspektimit si dhe të mbrojtjes së interesit publik. Nga auditimi në sistemin e e-inspektimit ka rezultuar se: Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kryer ri-inspektime për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara; nuk janë marrë asnjëherë mostrat e substancave në subjektet e nxjerrjes së naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz; komisioni i shqyrtimit të ankimeve është mbledhur tej afatit dhe ka shfuqizuar vendime të inspektimit për subjektin Albpetrol sh.a. Mos-inspektimi i subjekteve naftënxjerrëse për sa i përket korrigjimit të shkeljeve, nuk jep siguri për eliminimin e pasojave mjedisore nga subjektet ndotëse.

8.Gjetje nga auditimi: Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e mjedisit dhe për ushtrimin e kontrollit në zonat me problematika mjedisore, përfshirë ato të ndotura nga aktivitetet hidrokarbure, brenda territorit të tyre administrativ. Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024, Bashkisë Roskovec i është adresuar një ankesë nga banorët në lidhje me dyshimet për shkarkim të mbetjeve të rrezikshme gazi pranë gropës ekologjike nr. 7, e menaxhuar nga subjekti “B.. P..” sh.p.k. Në kundërshtim me kompetencat ligjore dhe dispozitat e Rregullores⁵⁶ për trajtimin e zonave problematike mjedisore, bashkia nuk ka marrë veprime konkrete verifikuese apo inspektuese për shqyrtimin e rastit, por është mjaftuar me përcjelljen e ankesës pranë subjektit privat, duke u shmangur nga ushtrimi i funksioneve të saj institucionale. Ky veprim përbën mangësi në zbatimin e funksioneve institucionale dhe riskon mosadresimin në kohë të problematikave me ndikim në shëndetin e komunitetit dhe cilësinë e mjedisit. Gjithashtu, u konstatua se gjatë gjithë periudhës së auditimit, Bashkia Roskovec nuk ka kryer asnjë verifikim apo kontroll mjedisor në subjektet naftënxjerrëse që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të saj. Po ashtu, Bashkia Patos nuk ka kryer monitorim për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme, duke treguar mungesë të vazhdueshme të ndjekjes së masave dhe angazhimit institucional për përmirësimin e situatës mjedisore në zonë.

9.Gjetje nga auditimi: Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” përcakton detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë. Subjektet “B.. P..” sh.p.k dhe “Albpetrol” sh.a që kryejnë veprimtari naftënxjerrëse në zonën Patos-Marinëz zotërojnë leje mjedisi “Tipi A/B”, në kushtet e së cilës përcaktohet edhe dorëzimi dy–katër herë, në vit i raporteve të vetmonitorimit të Lejes Mjedisore. Grupi i auditimit ka konstatuar se për periudhën 2021-2023, “Albpetrol”

⁵⁵ VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja, informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”.

⁵⁶ Rregullore e brendshme të Administratës së Bashkisë Roskovec dhe njërive administrative në varësi.

sh.a nuk ka dorëzuar raportet e vetmonitorimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator. Mosdorëzimi i raporteve të vetmonitorimit nga subjektet naftënxjerrëse sjell mos-monitorimin e shkarkimeve të veprimtarive.

10.Gjetje nga auditimi: Ligji “Për lejet e mjedisit” përcakton se, subjektet të cilat me veprimtarinë e tyre “ndotin” mjedisin duhet të pajisen me leje mjedisi. Nga auditimi rezultoi se, “Albpetrol” sh.a nuk ka pajisur me leje mjedisi 2 gropa ekologjike në zonën Patos-Marinëz. Zhvillimi i veprimtarisë pa lejen përkatëse të mjedisit sjellë dëmtrim të mjedisit në tërësi si dhe rreziqe ndaj jetës dhe shëndetit të qytetarëve.

11.Gjetje nga auditimi: Vendimi nr. 371, datë 11.6.2014, parashikon rregullat për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme. Nga auditimi rezultoi se, subjektet e nxjerrjes së naftës dhe gazit që operojnë në zonën Patos-Marinëz nuk kanë raportuar në sistemin online e-Albania për transfertat e kryera të mbetjeve të rrezikshme, pasi sistemi ende nuk është ndërtuar.

-Ndërkohë, sipas procesverbaleve të mbajtura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është përshkruar se, në territorin e subjektit “B.. P..” sh.p.k. ndodhen 86.5 mijë ton mbetje hidrokarbure, të mbetura pezull për asgjësim. Si pasojë e mosmarrëveshjeve të krijuara⁵⁷ për mbetjet hidrokarbure, subjektet naftënxjerrëse në zonën Patos-Marinëz nuk kanë arritur të minimizojnë ndikimin negativ në mjedis dhe shëndetin e qytetarëve si dhe nuk kanë siguruar menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve.

4.Konkluzione: Subjektet naftënxjerrëse që operojnë në zonën Patos-Marinëz nuk janë inspektuar dhe të monitoruara në mënyrë efektive nga strukturat përgjegjëse, me qëllim mbrojtjen e mjedisit në zonë.

7.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për të inspektuar dhe ri-inspektuar subjektet naftënxjerrëse që operojnë në zonën Patos-Marinëz, për konstatimin e korrigjimin e shkeljeve, si dhe të marrë mostra për ndikimet që kanë në mjedis (tokë, ujë, ajër) këto subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1.Rekomandim: Bashkia Roskovec dhe Bashkia Patos të marrin masa për:

- Hartimin dhe zbatimin e planeve të monitorimit të subjekteve hidrokarbure, që operojnë brenda juridiksionit të tyre administrativ;
- Kryerjen e inspektimeve dhe verifikimeve periodike në terren, me qëllim evidentimin e rasteve të mundshme të ndotjes mjedisore nga aktivitetet e nxjerrjes së naftës;
- Në rast të konstatimit të ndotjeve ose shkeljeve të legjislacionit mjedisor, të përcjellin rastet për ndjekje të mëtejshme pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe institucioneve të tjera përgjegjëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1.Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa ndëshkuese gjatë inspektimeve në terren për subjektet naftënxjerrëse të cilat nuk kryejnë dorëzimin e raporteve të vet monitorimit dhe t'i vlerësojë këto si subjekte me risk.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit të marrin masa për të inspektuar 2 gropat ekologjike në zonën Patos-Marinëz, të cilat nuk janë të pajisura me leje mjedisi si dhe të pezullojnë aktivitetin e tyre, derisa të pajisen me licencat përkatëse.

Menjëherë

11.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masa për krijimin e një ndërfaqeje në e-

⁵⁷ Mosmarrëveshja qëndron në faktin se cili prej kompanive do t'i trajtojë mbetjet: B.. P.. sh.p.k apo Albpetrol sh.a

Albania, për deklarimin e cdo transfertë të kryer të mbetjeve të rrezikshme nga subjektet naftënxjerrëse.

Menjëherë

11.2.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrin masa për të ngritur grupe pune të përbashkëta, për të inspektuar në territorin e subjektit “B.. P..” sh.p.k. sasinë gjendje të mbetjeve dhe asgjësimin e plotë të tyre.

Menjëherë

4.3 A janë të vlerësuara dhe të monitoruara rreziqet shëndetësore për banorët në zonën Patos-Marinëz?

4.3.1 A ka të dhëna shëndetësore dhe/ose studime epidemiologjike të kryera për banorët e zonës objekt auditimi?

➤ *KLSH-ja, auditime në fushën e shëndetit publik...*

Në njërin nga objektivat socialë të listuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, sanksionohet se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: standardin më të lartë shëndetësor”⁵⁸, meqë e drejta për kujdes shëndetësor nga shteti është një e drejtë kushtetuese, të cilën “e gëzojnë në mënyrë të barabartë, të gjithë shtetasit.”⁵⁹

Shëndeti publik është gjithashtu njëra ndër shtyllat kryesore për tu mbuluar me auditime performance në 5 vitet e ardhshme sipas Planit Strategjik 2023 – 2027 të KLSH⁶⁰.

Kjo do të thotë, se aspirata për një jetë të shëndetshme, e shtetasve që banojnë në zonat naftëmbajtëse, është një e drejtë e patjetërsueshme, as nga interesi ekonomik i industrisë së nxjerrjes/përpunimit, dhe as nga apatia që mundet të rrezikojë veprimtarinë e “sistemit të shëndetit publik”⁶¹, si rrjet shërbimesh dhe institucionesh të ndryshme.

Grupi i auditimit u shtri në të dhënat shëndetësore në 5 bashki që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin mjedisor nga aktiviteti i nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror, konkretisht: Bashkia Patos, Roskovec, Mallakastër, Kuçovë dhe Fier, si dhe në formë krahasimore u përzgjedhën edhe 2 bashki të tjera me karakteristika të ndryshme si Belshi, i kategorizuar si “Zonë C”, që ka një risk të ulët të tejkalimit të kufijve të ndotjes së përcaktuar dhe Elbasani si “Zonë A” e cila klasifikohet si zonë shumë e ndotur⁶².

Ndikimet kryesore të industrisë naftënxjerrëse në mjedis dhe burimet natyrore, të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në shëndet, janë:

-Ndotja e ajrit, ku emëtimi i gazeve si metani, dioksidi i squfurit dhe përbërjet organike të paqëndrueshme (VOCs), ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe për pasojë edhe në shëndetin e njerëzve. Djegia e gazit (flaring) dhe avullimi i kimikateve është një praktikë e zakonshme që ndikon direkt në përkeqësimin e cilësisë së ajrit.

-Ndotja e ujit, ku raportohen raste se uji i pijshëm është ndotur nga përbërësit e rrezikshëm si benzenë dhe toluene, të cilat mund të shkaktojnë probleme serioze shëndetësore. Shkarkimet e ujërave teknologjike, pa trajtim të duhur, janë një tjetër burim për ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

-Ndotja e tokës, ku derdhja e naftës dhe kimikateve në tokë, ka çuar në dëmtime të konsiderueshme të tokës bujqësore, gjë që ndikon në cilësinë e ushqimit dhe ekspozon popullatën ndaj ndotësve përmes zinxhirit ushqimor.

➤ *Hotspoti mjedisor Patos-Marinëz nuk ka një studim epidemiologjik nga Instituti i Shëndetit Publik.*

⁵⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 59, pika 1, germa c.

⁵⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 55, pika 1.

⁶⁰ Strategjia e Kontrollit të Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 247, datë 29.12.2022, faqe 23.

⁶¹ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 9, pika 1.

⁶² VKM nr. 412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”, 1.1.3.

Ligji Nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, përcakton se “*ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni*”⁶³. Instituti i Shëndetit Publik është përgjegjës për: informimin, këshillimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë në hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e shëndetit publik; sigurimin e ekspertizave; realizimin e studimeve të pavarura dhe prodhimin e informacioneve, bazuar në fakte”⁶⁴. Ky institut ka për detyrë të bëjë: “mbikëqyrjen epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe joinfektive; menaxhimin e regjistrave kombëtarë; informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik”⁶⁵.

Sipas strukturës, në ISHP funksionon Sektori i Epidemiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit. Ky sektor ka pikërisht për qëllim përmirësimin e njohurive mbi rolin e ekspozimeve mjedisore dhe përcaktuesve socio – ekonomik në shkaktimin e shfaqjes së sëmundjeve dhe traumave përmes studimeve epidemiologjike të përshtatshme për përcaktimin e ndërhyrjeve parandaluese. Ky sektor, realizon vlerësimin e impaktit që ka ndotja e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës, merr pjesë në ekspertiza mjedisore që lidhen me ndotjen urbane të shkaktuar nga një sërë burimesh, si dhe harton dhe realizon tema studimore lidhur me problemet shëndetësore që lidhen me ndotjen (cilësia e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm) nëpërmjet bashkëpunimit edhe me laboratorët e tjerë⁶⁶.

Krahas ISHP-së, funksionojnë edhe “Strukturat rajonale të shëndetit publik, të cilat duhet të përgatisin raporte vjetore për gjendjen shëndetësore të popullatës së rajonit që ato mbulojnë”. Këto raporte vjetore diskutohen me organet e pushtetit vendor dhe në të gjitha institucionet përgjegjëse për shëndetin publik, në nivel vendor. Çdo individ ka akses në treguesit e gjendjes së popullatës së çdo rajoni⁶⁷.

Grupi i auditimit, iu drejtua ISHP-së, nëse ka realizuar raporte vjetore dhe epidemiologjike për situatën shëndetësore në zonën Patos – Marinëz që lidhet me aktivitetin në fushën e hidrokarbureve dhe ndikimi në shëndetin e banorëve të këtyre zonave, si dhe a disponojnë raporte epidemiologjike në tërësi për impaktin në shëndet për banorët që jetojnë pranë burimeve ku nxirret nafta dhe gazi natyror.

Në përgjigje, ISHP informon se; disponohet vetëm një raport i vitit 2015 mbi vlerësimin e situatës mjedisore dhe shëndetësore në fshatin Marinëz – Fier, raport i cili lidhet me situatën e krijuar nga shpërthimi i gazit natyror nga nëntoka si pasojë e punimeve të një kompanie për nxjerrjen e naftës. Ndërkohë, nuk është kryer asnjëherë një studim për situatën e përgjithshme shëndetësore në zonën Patos – Marinëz apo në vendburime të tjera mbi impaktin e krijuar nga industria e nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror. Gjatë intervistimit, përfaqësuesit e ISHP, pjesë e Sektorit të Epidemiologjisë Ambientale dhe Kontrollit të Cilësisë së Ajrit deklaruan gjithashtu se nuk disponojnë asnjë pajisje për monitorimin e ajrit, çka e vështirëson studimin dhe analizimin për evidentimin në mënyrë shkencore për faktorët e dëmshëm mjedisorë (cilësia e ajrit) për shëndetin e popullatës.

-Gjithashtu, nga informacioni i administruar nga ISHP, nuk ka asnjë takim të mbajtur ndërmjet Drejtorive Rajonale të Shëndetit Publik me njësitë vendore të bashkive Fier, Patos, Roskovec, Kuçovë dhe Mallakastër, që rrjedhin nga ligji për shëndetin publik.

➤ *Shqetësimi për treguesit shëndetësorë.*

Grupi i auditimit iu drejtua ISHP –së me një pyetësor për t’u informuar mbi llojet e sëmundjeve të cilat potencialisht shkaktohen nga veprimtaria e nxjerrjes së naftës dhe gazit. Nga përgjigja e marrë: “*Referuar sëmundjeve të cilat derivojnë nga ekspozimet e ndotjes së ajrit (në varësi të kohës së ekspozimit të popullatave dhe niveleve të përqendrimit të ndotësve të ajrit urban) ndikojnë në zhvillim të sëmundjeve respiratore, kardiovaskulare dhe malinje.*

⁶³ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 12, pika 2.

⁶⁴ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 14, pika 1, 2 dhe 3.

⁶⁵ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 15, geramat a, b dhe e.

⁶⁶ Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ISHP, neni 23.2, <https://www.ishp.gov.al/p-content/uploads/2023/12/RREGULLLORE.pdf>

⁶⁷ Ligji “Për Shëndetin Publik”, neni 60.

Themi ndikojnë, sepse studimet me ndikim mjedisor janë shumë komplekse duke iu referuar dhe një sërë faktorësh predispozues, mundësues dhe jo vetëm faktorëve precipitues apo përkeqësues që lidhen me ekspozimet që lidhen me ndikimin apo dhe përkeqësimin e sëmundshmërive (sipas codit ICD-10).’’⁶⁸

Pikërisht në këto tre patologji, grupi i auditimit i KLSH-së u ndal me vëmendje të shtuar, gjatë shtjellimit të implikimeve që sjell mbi shëndetin, ndotja e zonave naftëmbajtëse.

Lidhur me statistikën me nivelet e grup sëmundjeve që ndikohen edhe nga ekspozimet ndaj ndotjes së ajrit, ISHP pas kërkesës së grupi të auditimit vuri në dispozicion të dhënat (sipas tabelës nr.12), me numër rastesh, me prevalencën në total, sipas viteve dhe sipas grup-moshës, e cila shpreh frekuencën e hasjes së sëmundshmërisë në popullatë. Llogaritja e prevalencës është realizuar për 10.000 banorë.

Referuar zonës së mbuluar nga ky auditim, përmbledhësja e mëposhtme mbi prevalencën e sëmundjeve respiratore, përmban të dhënat të detajuara, përkatësisht për Mallakastrën, Kuçovën, Fierin , Patosin, Roskovecin, Elbasanin dhe Belshin⁶⁹:

Tabela 12. Grup sëmundjet respiratore (nr. rastesh dhe prevalenca), në të gjithë zonat e kërkuara, për periudhat 2015-2018 & 2021-2024


Viti	Mallakastër	Prevalenca /10.000	Kuçovë	Prevalenca /10.000	Fier	Prevalenca /10.000	Patos	Prevalenca /10.000	Roskovec	Prevalenca /10.000	Elbasan	Prevalenca /10.000	Belsh	Prevalenca /10.000
2015	84	26.4	58	13.1	1165	62.7	37	10.1	62	21.2	2253	117.9	37	11.5
2018	94	29.6	67	16.2	1387	74.6	43	11.7	58	20	2472	129.4	48	14.9
2021	230	72.4	80	18.1	1727	92.9	18	4.9	714	246.3	2983	156.1	27	8.4
2022	376	118.3	78	18.5	854	41.2	31	8.5	749	254.6	3360	175.9	52	16.3
2023	1248	380.8	98	23.1	981	52.4	24	7.1	826	274.6	3896	189.3	68	21.5
2024	1358	427.4	94	24.3	1042	57.2	24	7.4	950	346.7	4141	218.7	57	18.5

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga ISHP

Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku 9. Prevalenca e sëmundjeve respiratore sipas Bashkive /10.000 banorë

Sëmundjet respiratore 2015-2018 & 2021-2024



Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga ISHP

Përpunoi: Grupi i auditimit

✓ Nga të dhënat grafike, vihet re se niveli më i lartë të prevalencës së sëmundjeve respiratore, është regjistruar në rrethin e Mallakastrës, në vitin 2024, me 427,4 raste, për çdo 10.000 banorë.

Ecuria e prevalencës së sëmundjeve respiratore në zonën e Mallakastrës ka arritur vazhdimisht në rritje të dukshme, nga 118.3 raste/10.000, në vitin 2022, deri në 427.4 raste/10.000 banorë në vitin 2024. Pra nga të dhënat konstatohet, gati një katërfishim të këtij treguesi shëndetësor në zonën e Mallakastrës. Popullsia aktuale e Mallakastrës është 31.744 banorë, por ndryshimet ndër vite si dhe shpërndarjen sipas grup-moshave të këtij treguesi, ISHP nuk e disponon.

⁶⁸ Përgjigje e ISHP – së dhënë pyetësorit të GA – së, më datë 28.04.2025.

⁶⁹ Elbasani dhe Belshi, janë përfshirë në mënyrë krahasimore. Elbasani si zonë me risk të lartë ndotjeje, ndërsa Belshi me risk të ulët, sipas përcaktimeve të VKM nr. 412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”, 1.1.3

✓ Në zonën e Kuçovës, sikurse nga Grafiku 9, tendenca e prevalencës ka pasur një ngritje, duke variuar nga 13.1 raste /10.000 (2015), në 18,1 raste /10.000 banorë, në vitin 2021, për të arritur në 24.3 raste/10.000 banorë në vitin 2024. Numri i popullsisë në këtë zonë, paralelisht ka pësuar rënie, 44.366 banorë në vitin 2015, në 38.688 banorë në vitin 2024.

✓ Referuar niveleve të prevalencës së sëmundjeve respiratore sipas grafikut, në zonën e Fierit, vihet re një regjistrim të 92.9 rasteve/10.000 banorë në 2021, tregues i cili bie në 41,2 raste/10.000 banorë në 2022, tregues i cili pëson rritje konstante, por të përmbajtur, në 2023 dhe 2024, me nga 52,4 dhe 57,2 raste/10.000 banorë. Popullsia totale e Fierit ka pësuar rënie ndër vite, nga 185.961 banorë në vitin 2021, në 182.358 në vitin 2024.

✓ Nga të dhënat e raportuara, mbi sëmundjet respiratore të zonës Patos-Marinëz vërehet një rritje e lehtë e vlerave të prevalencës nga viti 2015, në vitin 2018. Më pas prevalenca e sëmundjeve respiratore pëson një rënie drastike të këtij treguesi me afro 65%, nga 2018, në 2021, dhe më pas rritja e kësaj frekuence nga viti 2021, në vitin 2022 i hap “udhë” dy viteve 2023 dhe 2024, me tregues të prevalencës së sëmundjeve respiratore më të ulët. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga ISHP, konstatohet se ecuria e treguesit shëndetësor, të prevalencës së sëmundjeve respiratore në zonën e Patosit, ka pësuar ulje dhe ngritje periodike, me një nivel treguesi, gjithsesi anomalisht të ulët. Popullsia totale e Patos-Marinëz ka pësuar rënie ndër vite, nga 36.710 banorë në vitin 2021, në 32.762 në vitin 2024.

✓ Prevalenca e sëmundjeve respiratore në zonën e Roskovecit, nga viti 2015, deri në vitin 2018, ka ruajtur thuajse të njëjtin nivel, me një rënie të lehtë nga 21.2 raste, në 20 raste/10.000 banorë. Nga viti 2018 në vitin 2021, vërehet një rritje drastike prej 1200% e treguesit të prevalencës së sëmundjeve respiratore, duke kaluar nga 20 në 246.3 raste për 10.000 banorë. Kjo rritje alarmante në zonën e Roskovecit ndodh në një kohë kur nuk është shënuar asnjë ndryshim në treguesit mjedisor që përcaktojnë nivelin e ndotjes, duke ngritur dyshime serioze për saktësinë e të dhënave.

Grupi i auditimit ka krahasuar të dhënat e administruara nga ISHP për sëmundjet respiratore për zonën e Roskovecit, me të dhënat e raportit të ISHP-së për vitin 2015. Nga auditimi rezultoi se të dhënat e pasqyruara nuk janë të njëjta. Konkretisht, referuar raportit të ISHP-së të vitit 2015, raport i mbajtur pas situatës problematike që lidhet me shpërthimet në Marinëz, grupi që ka kryer studimin ka konkluduar mbi një kampion prej 416 familje, ku 19.2% e tyre kanë deklaruar se kanë të sëmurë me astmë bronchiale. Ky kampion në masën 19.2% të 416 familjeve, mund të përkthehet, në të paktën 80 persona me probleme respiratore, ndërkohë që nga informacioni i përcjellë nga ISHP, deklaroi për vitin 2015 vetëm 62 persona.

Grupi i auditimit, përdori gjithashtu metodën e pyetësorëve në popullatë, ku u pyetën banorë të ndryshëm që jetojnë pranë zonave naftënxjerrëse të zonës së Roskovecit, nga ku rezultoi se nga 46 persona të pyetur, 28 u përgjigjën pozitivisht për probleme që lidhen me rrugët e frymëmarrjes ose 61% e personave të pyetur.

Edhe në vitet 2022, 2023 dhe 2024 trendi i rritjes vijon, me një diferencë në ngritje prej 100 rastesh, nga viti 2021, në vitin 2024, (sipas të dhënave të dërguara nga ISHP).

Popullsia e Roskovecit ka pësuar rënie ndër vite, nga 28.999 banorë në vitin 2021, në 27.400 në vitin 2024.

✓ Sipas të dhënave të dërguara nga ISHP, prevalenca e sëmundjeve respiratore në zonën e Elbasanit manifeston një trend rritjeje konstante, me afro 50% të rasteve/10.000 banorë, nga viti 2021, në vitin 2024.

Popullsia totale ka pësuar rënie ndër vite, nga 191.135 banorë në vitin 2021, në 189.362 në vitin 2024.

✓ Po të vlerësojmë prevalencën e sëmundjeve respiratore në zonën e Belshit, konstatohet se ky tregues ka ndryshuar, në vlera të ndërmjetme midis 11,5 raste/10.000 banorë, deri në

nivelin 21,5 raste/10.000 banorë. Në një vlerësim krahasimor me realitetin e Kuçovës konstatohet se edhe kjo e fundit është mbajtur në vlera të përafërta, nga një minimum 13,1 rastesh,/10.000 banorë, deri në një maksimum, prej 24,3 rastesh/10.000 banorë.

Tabela 13. Prevalenca e sëmundjeve respiratore në Kuçovë, Belsh, për periudhën 2015, 2018, 2021-2024.

Prevalenca e sëmundjeve respiratore, për periudhën 2015-2028 & 2021-2024		
Viti	Kuçovë	Belsh
2015	13,1	11,5
2018	16,2	14,9
2021	18,1	8,4
2022	18,5	16,3
2023	23,1	21,5
2024	24,3	18,5

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP. Përpunoi: Grupi i Auditimit

Referuar krahasimit, të treguesit mbi prevalencën e sëmundjeve respiratore, midis dy realiteteve, atij të Bashkisë Kuçovë dhe atij të Bashkisë Belsh, vërehet se nuk ka ndryshime të ndjeshme në këto dy zona, të cilat referuar këtij indikator, nuk mund të diferencohen, njëra si zonë me ndotje të theksuar mjedisore, ndërsa tjetra si një zonë që nuk vuan ndotjen, përderisa nuk ka aktivitete nxjerrëse naftë dhe gazi në territorin e saj, ndryshe nga e para. Mbi bazën e të dhënave të ofruara nga ISHP, sa i përket treguesit mbi prevalencën e sëmundjeve respiratore, grupi i auditimit u fokusua te vlerësimi krahasimor midis Bashkisë Patos dhe Bashkisë Belsh.

Tabela 14. Prevalenca e sëmundjeve respiratore në Patos dhe Belsh, për periudhën 2015, 2018 & 2021-2024.

Prevalenca e sëmundjeve respiratore, për periudhën 2015-2028 & 2021-2024		
Viti	Patos	Belsh
2015	10,1	11,5
2018	11,7	14,9
2021	4,9	8,4
2022	8,5	16,3
2023	7,1	21,5
2024	7,4	18,5

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP. Përpunoi: Grupi i Auditimit

Po të krahasojmë prevalencën e sëmundjeve respiratore (Tabela 14), vërehet se ky tregues shëndetësor në Belsh, në 2021, ishte shumë më problematik me 8,4 raste/10.000 banorë, sesa në Bashkinë Patos, me 4,9 raste/10.000 banorë. Ky trend vijon e përkeqësohet me një thellim të diferencës në 2022, me 16,3 raste/10.000 banorë Bashkia Belsh dhe 8,5 raste/10.000 banorë Bashkia Patos. Në vitin 2023 raporti i treguesit thellon diferencën në trefish, midis Bashkisë Belsh dhe Bashkisë Patos, duke arritur në 21,5 raste/10.000 banorë në Bashkinë Belsh dhe 7,1 raste/10.000 banorë në Bashkinë Patos. Në vitin 2024 vazhdon e njëjta ecuri e treguesit të prevalencës së sëmundjeve respiratore, të vënë në dispozicion nga ISHP, nga ku rezulton se në Bashkinë Belsh regjistrohen 18,5 raste/10.000 banorë, ndërsa në Bashkinë Patos regjistrohen 7,4 raste/10.000 banorë. Problemi i madh është se Bashkia Belsh nuk vuan nga ndotja mjedisore, ndaj duhet të ketë tjetër prevalencë të sëmundjeve respiratore, krahasuar me Bashkinë Patos. Ky kontrast i pazakontë u diskutua edhe me Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), i cili nuk paraqiti asnjë argument apo analizë shkencore që të shpjegonte këtë mospërputhje në të dhënat mes dy bashkive.

Lidhur me sëmundjet respiratore, u kërkua informacion nga 5 qendra shëndetësore të disa fshatrave të Bashkisë Patos, konkretisht për Qendrat Shëndetësore për fshatrat Belinë, Verbas, Frashër, Sheqisht dhe Zharrëz. Nga përpunimi i këtyre të dhënave, rezultojnë disa të dhëna kontradiktore, konkretisht:

Nëse i referohemi të dhënave të dërguara nga ISHP, për vitin 2021 rastet e sëmundjeve respiratore për gjithë Bashkinë e Patosit rezultojnë 18 të tilla, ndërkohë që vetëm për vitin 2021, 3 qendrat shëndetësore (në të cilat shtrihet industria e naftës) të fshatrave Verbas,

Frashër dhe Sheqishtë, deklarojnë 17 persona me sëmundje respiratore, pra 1 më pak se gjithë Bashkia Patos.

Grupi i Auditimit, përdori gjithashtu metodën e pyetësorëve në popullatë, ku u pyetën banorë të ndryshëm që jetojnë pranë zonave naftënxjerrëse të zonës së Patosit, nga ku rezultoi se nga 30 persona të pyetur, 20 u përgjigjën pozitivisht për probleme që lidhen me rrugët e frymëmarrjes ose 66.6% e personave të pyetur, ku 3 prej tyre të diagnostikuar me sëmundjen e astmës.

Sa më sipër, të dhënat e vëna në dispozicion nga ISHP nuk i korrespondojnë realitetit faktik dhe si të tilla duhen marrë me “rezervë”, pasi panorama e pasqyruar nga banorët e zonave të ndotura, por edhe të dhënat që vijnë nga qendrat shëndetësore, paraqesin një situatë më problematike, të paktën për sëmundjet respiratore të kësaj popullate. Të dhënat e pasqyruara nga ISHP për zonën e Patosit si zonë e ndotur nga aktiviteti i nxjerrjes së naftës dhe gazit, tregon se banorët janë më të shëndetshëm sesa në një zonë pa ndotje, si ajo e Bashkisë Belsh.

Në vijim, paraqiten evidencat statistikore të vëna në dispozicion nga ISHP, lidhur me kategorinë e dytë patologjike nga të cilat preken tendencialisht, komunitetet e ekspozuara ndaj ndotjes mjedisore, për shkak të aktiviteteve nxjerrëse të naftës dhe gazit, në bashkitë ku u fokusua auditimi. Më poshtë në formë tabelare janë evidentuar prevalencat e sëmundjeve kardiovaskulare, për komunitetet përkatëse të bashkive, për vitet 2015, 2018 dhe 2021-2024.


Tabela 15. Grup sëmundjet kardiovaskulare (numër rastesh dhe prevalenca), në të gjithë zonat e përcaktuara, për vitet 2015, 2018 & 2021-2024

Viti	Mallakastër	Prevalenca /10.000	Kuçovë	Prevalenca /10.000	Fier	Prevalenca /10.000	Patos	Prevalenca /10.000	Roskovec	Prevalenca /10.000	Elbasan	Prevalenca /10.000	Belsh	Prevalenca /10.000
2015	363	114.2	117	26.4	7192	386.8	197	53.7	481	165.9	10660	557.7	560	174.1
2018	434	136.6	152	36.7	7364	396	160	43.6	535	184.5	12073	631.6	661	205.5
2021	445	140.1	193	43.5	5810	312.5	90	24.5	83	28.6	12055	630.7	559	173.8
2022	593	286.6	171	40.6	7099	341.8	71	19.3	119	40.5	12662	663	518	161.7
2023	581	182.9	179	42.1	7475	399	77	22.7	181	60.2	14276	693.6	668	210.7
2024	637	200.5	196	50.7	7595	416.5	79	24.1	177	64.6	16512	872	504	163.8

Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga ISHP

Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku 10. Prevalenca e sëmundjeve kardiovaskulare sipas Bashkive /10.000 banorë



Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP.

Përpunoi: Grupi i auditimit

✓ Sëmundjet kardiovaskulare në zonën Mallakastër, gjatë viteve 2015, 2018 & 2021-2024 manifestojnë një trend në rritje të vazhdueshme me një koeficient thuhet konstant, duke filluar në vitin 2015, me një prevalencë prej 114.2 raste/10.000 banorë, duke përfunduar në vitin 2024 me një prevalencë prej 200.5 raste/10.000 banorë. Rastet kanë pësuar thuhet dyfishim të tyre në vitet e referimit.

✓ Situata në Kuçovë, lidhur me prevalencën e sëmundjeve kardiovaskulare shfaq të njëjtën tendencë rritjeje, sikurse në rastin e Mallakastrës, duke filluar në vitin 2015, me një

prevalence prej 26,4 raste/10.000 banorë, duke përfunduar në vitin 2024 me një prevalencë prej 50,7 raste/10.000 banorë. Rastet kanë pësuar thujse dyfishim të tyre në vitet e referimit.

✓ Ndërsa treguesi shëndetësor i prevalencës së sëmundjeve kardiovaskulare në zonën Fier, gjatë periudhës së vëzhguar shfaq një tendencë në ulje, në vitin 2021 dhe më pas, rritje në tre vitet e tjera 2022-2024. Niveli i prevalencës gjatë kësaj periudhe lëviz nga 386.8 raste /10.000 banorë, në 416.5 raste/10.000 banorë, duke mos pasur luhatje të mëdha.

✓ Emblematike është ecuria e prevalencës së sëmundjeve kardiovaskulare në zonën e Patosit, ku gjatë periudhës së vëzhguar, nivelet e frekuencës së sëmundjeve kardiovaskulare shfaqën një tendencë në rënie, me përgjysmim të treguesit thujse. Në vitin 2015 statistikat regjistrojnë 53 raste/10.000 banorë, ndërsa në vitin 2024 niveli arrin në 24.1 raste/ 10.000 banorë. Pra, ndryshe nga situata në Mallakastër dhe Kuçovë, ku prevalencë e sëmundjeve kardiovaskulare është thujse dyfishuar, në rastin e Patosit, kemi një përgjysmim të prevalencës së sëmundjeve kardiovaskulare.

✓ Ecuria e frekuencës së prekshmërisë nga sëmundjet kardiovaskulare për komunitetin e Bashkisë Roskovec, ngre “pikëpyetje”, lidhur me rënien e numrit të rasteve nga viti 2018 (184,5 raste/10.000 banorë), në vitin 2021, në një rënie në 2021(28,6 raste/10.000 banorë), në thujse në një tregues, ekuivalenti i një të gjashtës së treguesit të vitit 2018. Referuar ndryshimeve ndër vite i prevalencës në fjalë, ky raport treguesish gjashtë me një, të krijuar gjatë një hendeku kohor prej tre vitesh, nuk mund të justifikohet nga diafragma kohore.

-Në vijim u krahasuan të dhënat e prevalencës së sëmundjeve kardiovaskulare në juridiksionin e bashkisë së Roskovecit me ato të 2 qendrave shëndetësore të fshatrave ku shtrihen subjektet naftënxjerrëse (Marinëz, Kuman).

-Për vitin 2021, në informacionin e dërguar nga ISHP, rezulton se për Roskovecin nr. i rasteve përsa i përket sëmundjeve kardiovaskulare ishte 83 persona, ndërsa për të njëjtin vit, qendrat shëndetësore Kuman dhe Marinëz deklarojnë 282 persona me sëmundje kardiovaskulare.

-Për vitin 2022, ISHP deklaron 119 persona me sëmundje kardiovaskulare, ndërsa për të njëjtin vit 2 qendrat shëndetësore të fshatrave Marinëz dhe Kuman deklarojnë 315 persona me sëmundje kardiovaskulare.

- Për vitin 2023, ISHP deklaron 181 persona me sëmundje kardiovaskulare, ndërsa për të njëjtin vit 2 qendrat shëndetësore të fshatrave Marinëz dhe Kuman deklarojnë 370 persona me sëmundje kardiovaskulare.

- Për vitin 2024, ISHP deklaron 177 persona me sëmundje kardiovaskulare, ndërsa për të njëjtin vit 2 qendrat shëndetësore të fshatrave Marinëz dhe Kuman deklarojnë 399 persona me sëmundje kardiovaskulare.

Sa më sipër, konstatohet një përplasje e të dhënave të administruar në të dyja rastet nga ISHP, ku për gjithë zonën e Roskovecit për periudhën 2021-2024 deklarohen 560 persona me sëmundje kardiovaskulare, ndërkohë që për të njëjtën periudhë nga qendrat shëndetësore të fshatrave Marinëz dhe Kuman (2 nga qendrat shëndetësore) që janë pjesë përbërëse e Bashkisë Roskovec, deklarohen 1366 persona. Sa më sipër, e dhëna e dytë përcjell një informacion që shkon mbi 100% më shumë persona me sëmundje kardiovaskulare, duke paraqitur një situatë alarmante, kjo referuar edhe prevalencës për 10.000 banorë në këto dy fshatra, dhe gjithashtu vënë në “pikëpyetje”, të dhënat e përcjella nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor pranë ISHP.

✓ Ndërsa treguesi shëndetësor i prevalencës së sëmundjeve kardiovaskulare në zonën e Elbasanit, gjatë periudhës së vëzhguar konstatohet një rritje e përvitshme, e cila ndërmjet vitit 2015 dhe atij 2024, prevalenca shkon nga 557.7/10000 (viti 2015) deri në 872/10000 (viti 2024), pra rritja në këtë bashki shkon në 64% më shumë persona me sëmundje kardiovaskulare.

✓ Treguesit shëndetësor për zonën e Belshit, krijojnë sërish një situatë emblematike ndërmjet zonave të klasifikuara si të ndotura dhe kësaj zone. Konkretisht, të dhënat për Belshin, paraqesin me ulje – ngritje konstante, një numër relativisht të lartë të sëmurësh kardiovaskular, ku prevalenca është ndërmjet 161/10.000 persona në vitin 2022, në 210/10.000 në vitin 2023. Këto të dhëna, nëse i krahasojmë me zonat e Patosit, Roskovecit apo edhe Kuçovës të cilat janë aktive në industrinë e nxjerrjes së naftës, n'a paraqesin një tablo shqetësuese të kësaj zone, e cila klasifikohet si zonë me risk të ulët mjedisor.

Tabela nr.16. Prevalenca e sëmundjeve kardiovaskulare

Prevalenca e sëmundjeve kardiovaskulare, për periudhën 2015-2028 & 2021-2024				
Viti	Kuçovë	Patos	Roskovec	Belsh
2015	26.4	53.7	165.9	174.1
2018	36.7	43.6	184.5	205.5
2021	43.5	24.5	28.6	173.8
2022	40.6	19.3	40.5	161.7
2023	42.1	22.7	60.2	210.7
2024	50.7	24.1	64.6	161.8

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP.

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Siç evidentohet edhe nga tabela e mësipërme, në secilin nga vitet ku janë marrë të dhënat e sëmundjeve kardiovaskulare, Bashkia Belsh rezulton me një prevalencë shumë të lartë të sëmurëve kardiovaskularë në raport me Bashkitë e tjera të cituara më sipër, bashki të cilat ndryshe nga ajo e Belshit janë zona ku është aktive industria e nxjerrjes së naftës. Në secilin rast, sidomos nëse të dhënat i krahasojmë me ato të Patosit apo edhe Kuçovës, rezulton se: Belshi varion me një prevalencë që shkon të paktën vitin e fundit në 670% më shumë krahasuar me Patosin dhe 310% më shumë me Kuçovën.

➤ *Spitali i Fierit, në vend të dytë në rang republike për shtrimet në spital, për sëmundjet malinje...*

Në vijim, paraqiten evidencat statistikore të vëna në dispozicion nga ISHP, lidhur me kategorinë e tretë patologjike nga të cilat preken potencialisht, komunitetet e ekspozuara ndaj ndotjes mjedisore, për shkak të aktiviteteve nxjerrëse të naftës dhe gazit, në bashkitë ku u fokusua auditimi. Më poshtë në formë tabelare janë evidentuar prevalencat e sëmundjeve malinje, për komunitetet përkatëse të bashkive, për vitet 2015, 2018 dhe 2021-2024.

Tabela 17. Grup sëmundjet malinje (numër rastesh dhe prevalenca), në të gjithë zonat e përcaktuara, për vitet 2015, 2018 & 2021-2024

Viti	Mallakastër	Prevalenca /10.000	Kuçovë	Prevalenca /10.000	Fier	Prevalenca /10.000	Patos	Prevalenca /10.000	Roskovec	Prevalenca /10.000	Elbasan	Prevalenca /10.000	Belsh	Prevalenca /10.000
2015	21	6.6	17	3.9	393	21.2	40	10.9	20	6.9	431	22.6	23	7.2
2018	26	8.2	26	6.3	421	22.7	31	8.5	30	10.4	617	32.3	141	43.9
2021	42	13.2	29	6.5	837	45.1	25	6.8	25	8.6	549	28.7	81	25.2
2022	38	12	16	3.8	903	43.5	25	6.8	25	8.5	553	29	9	2.81
2023	42	13.2	24	5.7	1030	55	37	10.9	37	13.3	573	27.8	5	1.6
2024	32	10.1	35	9.1	1112	61	30	9.2	30	11	714	37.7	14	4.6


Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP⁷⁰.

Përpunoi: Grupi i auditimit

⁷⁰ Të dhënat e paraqitura në tabelën 17, janë konsideruar gjatë takimit të mirëkuptimit me ISHP me mangësi, duke pranuar faktin se janë paraqitur të dhëna të pa përpunuara saktë.

Grafiku 11. Prevalenca e sëmundjeve malinje sipas Bashkive /10.000 banorë

Malinje 2015-2018 & 2021-2024



Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP.

Përpunoi: Grupi i auditimit

✓ Sëmundjet malinje në zonën Mallakastër, gjatë viteve 2015, 2018 & 2021-2024 paraqet përgjithësisht një trend në rritje, duke filluar në vitin 2015, me një prevalencë prej 6.6 raste/10.000 banorë si vlera më e ulët për periudhat, duke arritur pikun në vitet 2021 dhe 2023 me 42 raste ose një prevalencë prej 13.2 raste/10.000 banorë. Siç evidentohet, rastet kanë pësuar thujse dyfishim të tyre në vitet e referimit.

✓ Në Kuçovë, treguesit e sëmundjeve malinje në popullatë për vitet referuese, japin të dhëna të cilat nga viti 2015 në vitin 2024 kapërcejnë dyfishin e personave me sëmundje malinje, ku për vitin 2015 kemi 17 persona ose prevalencë prej 3.9/10.000 ndërsa në vitin 2024 kemi 35 persona ose prevalencë prej 9.1/10.000.

✓ Të dhënat që ofrohen nga Fieri, paraqesin një situatë alarmante për sëmundjet malinje të kësaj popullate, e cila nga viti në vit ka ardhur duke u shtuar në numër. Nëse për vitin 2015, sëmundshmëria ishte me 393 persona ose prevalencë prej 21.2/10000, ky numër ka ardhur çdo vit me ngritje dhe në vitin 2024 janë regjistruar 1112 persona ose gati 300% më shumë persona me sëmundje malinje, ku prevalenca vitin e fundit rezulton 61/10.000 banorë. Të dhënat për rritjen e vazhdueshme të të sëmurëve malinjë në zonën e Fierit, evidentohen edhe nga Raporti i ISHP-së për kanceret në Shqipëri, konkretisht për shtrimet në spitale që lidhen me këtë patologji, Fieri rezulton me 3071 shtrime gjithsej, pa llogaritur edhe 143 shtrime të tjera në Spitalin “Memorial” Fier. Kjo e vendos Fierin në vend të dytë për shtrime që lidhen me këtë sëmundje pas QSUNT dhe është ndjeshëm shumë herë më lart se sa të dhënat që deklarohen spitale të tjera të vendit.

✓ Nga ana tjetër, Patosi sjell sërish të dhëna në dukje jo alarmante për sëmundjet malinje. Nga vitet referuese më problematik mund të konsiderohet viti 2015 ku raportohen 40 të sëmurë me prevalencë prej 10.9/10.000 banorë. Në vijim shifrat kanë ardhur në ulje ku vitet 2021 dhe 2022 regjistrojnë sipas të dhënave të dërguara 25 banorë ose prevalencë prej 6.8/10.000 banorë dhe viti i fundit regjistron 30 të sëmurë, ose prevalencë prej 9.2/10.000 banorë.

✓ Edhe Roskoveci paraqet të dhëna të cilat përgjithësisht kanë një rritje nga viti 2015 ku prevalenca është 6.9/10.000 banorë, me pikun në vitin 2023 me gati 90% më shumë ose prevalencë 13.3/10.000 banorë. Situata e paraqitur për vitin 2024 është për një prevalencë prej 11/10000 banorë.

Lidhur me të dhënat e administruara nga Roskoveci, u krahasua me ato të 2 qendrave shëndetësore Marinëz dhe Kuman, situata shfaqet problematike, duke vënë në diskutim informacionin e dërguar nga NjVKSh - Fier. Konkretisht, për vitin 2015, në gjithë Bashkinë Roskovec deklarohen 20 persona me sëmundje malinje, rezulton se për të njëjtin vit deklarohen 19 të sëmurë vetëm nga qendrat shëndetësore Marinëz dhe Kuman. Për vitin 2018, në gjithë Roskovecin deklarohen 30 të sëmurë malinje ndërsa për këto 2 QSH - 22 persona.

Për vitin 2021, deklarohen 25 në gjithë Roskovecin dhe për të njëjtin vit deklarohen 21 nga këto 2 QSH. Për vitin 2022, deklarohen 25 për gjithë Roskovecin, ndërkohë për këto 2 qendra shëndetësore deklarohen 28 të sëmurë, pra 3 më shumë. Për vitin 2023, deklarohen 37 për gjithë Roskovecin, ndërkohë që vetëm në 2 QSH deklarohen 28 të sëmurë malinjë, dhe për vitin 2024, deklarohen 30 për gjithë Roskovecin, ndërkohë që vetëm në 2 QSH deklarohen 27 të sëmurë malinjë.

Sa më sipër, është evidente se të dhënat e dërguar nga NjVKSH Fier të ISHP dhe këta të fundit përcjellë grupit të auditimit, paraqesin mangësi, pasi në disa raste të dhënat e gjithë rajonit të Roskovecit janë pothuaj të njëjta me ato të vetëm 2 QSH të kësaj bashkie, ku në një rast, konkretisht për vitin 2022, deklarohen më shumë në 2 QSH se sa në gjithë zonën e Roskovecit. Kjo situatë, së pari sjell deformim të të dhënave dhe situatën në tërësi, por edhe vënë në diskutim mënyrën se si institucionet rajonale të shëndetit publik administrojnë dhe përcjellin informacionin mbi situatën shëndetësore të njësive ku operojnë. Duke ofruar të dhëna jo të sakta, kjo sjell risk të lartë edhe për paraqitjen e të dhënave jo vetëm rajonale por edhe ato të përgjithshme të shëndetit publik në Shqipëri, ku raportet e publikuara mbi situatën e përgjithshme, mund të bëhen me të dhëna jo të sakta.

Njëkohësisht, duke vlerësuar të dhënat e ardhura vetëm nga 2 QSH, rezulton se në zonën e Marinës dhe asaj të Kumanit, situatat shëndetësore mund të konsiderohet alarmante, pasi numri i personave me sëmundje malinje është relativisht i lartë ku çdo vit sipas këtyre të dhënave, janë rreth 20 deri në 30 persona me sëmundje malinje, ku për krahasim, për të njëjtën periudhën (tre vitet e fundit) Bashkia Belsh ka 100% deri në 500% më pak raste se sa 2 QSH të Roskovecit.

Tabela nr. 18. Numri i personave me sëmundje malinje

Numri i personave me sëmundje malinje, për periudhën 2015, 2018 & 2021-2024			
Viti	Roskovec	Marinëz	Kuman
2015	20	8	11
2018	30	6	16
2021	25	4	17
2022	25	9	19
2023	37	9	19
2024	30	13	14

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga ISHP.

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Ndërkohë, ndryshe nga QSH Kuman dhe Marinëz të cilat paraqesin të dhëna problematike mbi sëmundjet respiratore, kardiovaskulare dhe malinje, QSH Jagodinë sipas të dhënave të paraqitura rezulton se për vitin 2015 ka 13 të sëmurë cardiovasculare dhe për vitin 2018 dhe 2021-2024 nuk ka asnjë person me sëmundje cardiovasculare. E njëjta situatë është edhe për sëmundjet respiratore ku për vitin 2015 raportohen 2 të sëmurë, dhe në vijim për vitet 2018 dhe 2021-2024 asnjë person me sëmundje respiratore, ndërsa për sëmundjet malinje, për gjithë periudhën së raportuar nuk raportohet asnjë i sëmurë.

Këto të dhëna, pavarësisht se Jagodina konsiderohet si zonë me aktivitet të lartë në fushën e nxjerrjes së naftës, japin një panoramë të pabesueshme, pasi të dhënat shëndetësore që vijnë nga kjo QSH nuk përkojnë me realitetin, duke vënë në diskutim të dhënat e dërguara.

✓ Ndërkohë edhe situata e të sëmurëve malinjë në zonën e Elbasanit paraqet një rritje të shifrave, ku nga viti 2015 deri në vitin 2024, rritja është me gati 60% më shumë të sëmurë, ku për vitin 2015 kemi 431 persona ose prevalencë prej 22.6/10.000, ndërsa për vitin 2024 kemi 714 persona ose prevalencë prej 37.7/10000 banorë.

✓ Lidhur me Belshin dhe sëmundjet malinje, rezulton se kjo zonë në vitin 2018 ka përcjellë një numër të lartë të personave me këto sëmundje, ku prevalenca është prej 43.9/10.000, me një zbritje të ndjeshme për vitin 2021 me 25.2/10.000 për banorë dhe një ulje të theksuar me 2.81/10.000 në vitin 2022, 1.6/10.000 në vitin 2023 dhe 4.6/10.000 për vitin 2024.

Krahasimisht, konstatohet se edhe për shkak të popullsisë më të madhe, Fier dhe Elbasani krahas numrit më të madh të personave të diagnostikuar me sëmundje malinje, ky tregues ka ardhur me një rritje të madhe ku Fieri rezultoi me mbi 300% rritje rastesh ndërmjet vitit 2015 deri me 2024, ndërsa Elbasani me 65% më shumë raste ndërmjet viteve 2015 dhe 2024. Lidhur me zonat e tjera të cilat janë njëkohësisht edhe pjesë e impaktit të industrisë së nxjerrjes së naftës, evidentohen sidomos në Mallakastër, Kuçovë dhe Roskovec një rritje e numrit të personave me sëmundje malinje. Shqetësues është edhe fakti se ndërkohë që deklarohet nga të dhënat turrje e popullsisë së këtyre zonave, në vend që të shoqërohej me ulje të prevalencës, e kundërta ka ndodhur, pra kemi rritje ku në disa raste shkon edhe mbi 100%. Krahasimisht, Belshi prezanton një panoramë tjetër lidhur me sëmundjet malinje, ku sidomos 3 vitet e fundit kemi një ulje të theksuar, ku viti 2023 ka 5 të sëmurë malinjë me një prevalencë prej 1.6/10.000 banorë.

➤ *Vdekshmëria mesatare më e ulët se mesatarja kombëtare.*

Grupi i auditimit kërkoi informacion nga Bashkia Patos dhe Roskovec lidhur me vdekshmërinë në total në të dyja këto bashki si dhe për disa nga fshatrat që konsiderohen si Hotspot për shkak të aktivitetit të nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror.

- Nga informacioni i administruar⁷¹, rezultoi se në Bashkinë Roskovec mesatarja e vdekjeve është si vijon:

Tabela nr. 19. Mesatarja e vdekjeve.

Viti	Nr. Total i Vdekjeve	Mosha mesatare e vdekjeve
2021	243	74.24
2022	184	74.7
2023	132	75.7
2024	167	74.2

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga Bashkia Roskovec.

Përpunoi Grupi i Auditimit

- Bashkia Patos, ka vënë në dispozicion informacion⁷² për vdekjet në 5 fshatra të konsideruar Hotspot, si vijon:

Tabela nr. 20.

Fshati	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024	
	Nr.	Mosha mesatare	Nr.	Mosha mesatare	Nr.	Mosha mesatare	Nr.	Mosha mesatare
Belinë	10	73.6	5	76.8	4	77	4	74.7
Sheqishtë	14	72.9	8	61.7	11	75.9	9	62.4
Frashër	4	80	3	79	1	63	6	80.6
Verbas	7	82.2	6	75.8	6	68	4	80
Zharrëz	22	66.5	26	76.1	18	78.5	15	77.4
Total	57	75.04	48	73.88	40	74.1	38	75.02

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga Bashkia Patos.

Përpunoi Grupi i Auditimit

Sa më sipër, rezultoi se për 4 vite në Roskovec, mesatarja e vdekshmërisë është 74.71 vjeç, ndërkohë që për të njëjtën periudhë në 5 fshatra të Bashkisë Patos, mesatarja e vdekshmërisë është 74.51, dhe në veçanti ajo e Sheqishtes që shkon në 68.2 vjeç.

Nga informacioni i marrë, paraqiten të dhënat e EUROSTAT për jetëgjatësinë e 35 vendeve të Evropës, ku jetëgjatësia në Shqipëri për vitin 2022 arriti në 79.1 vjeç⁷³.

Krahasimisht, rezultoi se jetëgjatësia e popullsisë që jeton në zonën Patos – Marinëz, është mesatarisht 4.5 vite më e ulët se sa ajo e popullsisë së Shqipërisë.

12.Gjetje nga auditimi: Zona Patos–Marinëz, me një popullsi prej rreth 34,559 banorësh⁷⁴, përballlet me ekspozim të vazhdueshëm ndaj ndotjes mjedisore të shkaktuar nga aktivitetet intensive të nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror. Këto aktivitete përbëjnë një risk të konsiderueshëm për shëndetin publik, por deri më sot, Instituti i Shëndetit Publik dhe Njësitë Vendore të Shëndetit Publik nuk kanë kryer studime të mirëfillta apo analiza të detajuara

⁷¹ Administruar me e-mail të datës 19.05.2025 nga përfaqësuesit e Bashkisë Roskovec.

⁷² Administruar me e-mail të datës 16.05.2025 nga përfaqësuesit e Bashkisë Patos.

⁷³ <https://monitor.al/jetegjatesia-mesatare-ne-shqiperi-15-vite-me-e-ulet-se-mesatarja-e-be-se-ne-2022-arrin-nivelin-e-parapandemise/>

⁷⁴ Sipas Censurit të popullsisë, viti 2023 për Bashkitë Patos dhe Roskovec, <https://www.instat.gov.al/media/14305/cens-2023-fieri.pdf>

epidemiologjike që të vlerësojnë dhe dokumentojnë ndikimin real të këtyre proceseve industriale mbi shëndetin e komuniteteve lokale. Kjo mungesë e theksuar e vlerësimeve shkencore përbën një boshllëk serioz në kuptimin dhe menaxhimin e rreziqeve shëndetësore për banorët e kësaj zone.

13.Gjetje nga auditimi: Të dhënat e vëna në dispozicion nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), në lidhje me incidencën e sëmundjeve respiratore, kardiovaskulare dhe malinje, rezultojnë të jenë kontradiktore dhe potencialisht jo përfaqësuese për realitetin në terren. Një shembull domethënës është krahasimi mes dy zonave me profile të ndryshme mjedisore: Belshi, një zonë e konsideruar si e pastër nga pikëpamja mjedisore⁷⁵, raportohen nivele të sëmundshmërisë respiratore trefish më të larta se në Patos, një nga zonat më të ndotura për shkak të aktivitetit të nxjerrjes së naftës. Kjo mospërputhje, ngre dyshime serioze mbi cilësinë dhe saktësinë e mbledhjes së të dhënave, si dhe mbi mungesën e një monitorimi sistematik dhe të ndjekshëm ndaj faktorëve mjedisorë në zonat e ekspozuara ndaj ndotjes.

-E njëjta situatë paraqitet edhe me sëmundjet kardiovaskulare. Të dhënat e raportuara nga ISHP, të përcjella nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor nuk përputhen.

Për periudhën 2021 – 2024, në të gjithë zonën e bashkisë së Roskovecit janë raportuar zyrtarisht 560 raste me patologji kardiovaskulare, ndërkohë që nga i njëjti burim informacioni, raportohet që vetëm 2 qendra shëndetësore të kësaj bashkie të jenë evidentuar 1,366 raste me të njëjtën patologji për të njëjtën periudhë.

Këto mospërputhje të theksuara midis të njëjtin burim zyrtar, ngrenë pikëpyetje serioze mbi besueshmërinë e sistemit të raportimit dhe vënë në dyshim vlerësimin real të gjendjes shëndetësore të popullatës në zonat e prekura nga ndotja industriale.

14.Gjetje nga auditimi: Lidhur me sëmundjet malinje, pavarësisht rezervave mbi saktësinë e të dhënave të ofruara nga Instituti i Shëndetit Publik, konstatohet një prirje në rritje e kësaj patologjie pothuajse në të gjitha bashkitë e përfshira në objektin e auditimit, me përjashtim të Bashkisë Belsh, e konsideruar si zonë me ndotje të ulët.

Në bashkitë e tjera, veçanërisht në ato me ekspozim të lartë të ndotjes mjedisore, vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të rasteve me sëmundje malinje. Krahasuar të dhënat e vitit 2024 me ato të vitit 2015, Bashkia Fier paraqet një rritje të prevalencës së rasteve prej 62/10,000 banorë nga 21.2/10,000 që ishin në vitin 2015, ndërsa Bashkia Kuçovë ka një prevalencë rastesh prej 9.1/10,000 banorë nga 3.9/10,000 që ishin në vitin 2015.

Këto të dhëna nxjerrin në pah ndikimin serioz që ndotja mjedisore dhe në veçanti aktivitetet e nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror, kanë në shëndetin publik.

5.Konkluzion:

-Mospërputhjet e dukshme ndërmjet të dhënave të dërguara nga ISHP sipas raportimit nga strukturat lokale të kujdesit shëndetësor, tregojnë për një mungesë koherence, transparence dhe besueshmërie në sistemin e monitorimit të sëmundshmërisë.

-Mungesa e një studimi për impaktin shëndetësor në zonat ku kryhet aktiviteti i nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror, mund të sjellë pasoja serioze dhe afatgjata, si për individët ashtu edhe për komunitetin në tërësi. Mungesa e studimeve të mirëfillta, sjell pasojë mos njohjen nga komuniteti të riskut që vjen nga ekspozimi pranë këtyre zonave, pse jo edhe për të parandaluar sadopak impaktin shëndetësor që vjen nga kjo industri.

-Të dhënat në rritje për sëmundjet malinje në bashkitë me ndotje të lartë, përballë një stabiliteti relativ në zona si Belshi, tregojnë për një lidhje të mundshme mes ekspozimit afatgjatë ndaj ndotjes industriale dhe përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës. Rritja me ritme alarmante e rasteve me patologji malinje në periudhën 2015-2024, në mungesë të faktorëve të tjerë që do ta justifikonin këtë ndryshim, thekson nevojën urgjente për raportim të thelluar shkencor dhe përforsim të masave të mbrojtjes mjedisore dhe shëndetësore.

⁷⁵ VKM nr. 412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”, 1.1.3

Kjo tendencë jo vetëm që konfirmon impaktin potencialisht të rrezikshëm të aktivitetit të nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror mbi shëndetin publik, por gjithashtu, evidenton dobësitë strukturore të sistemit të monitorimit shëndetësor dhe mungesës së ndërhyrjeve të targetuara në zonat më të prekura. Pa veprime të drejtpërdrejta dhe të bazuara në evidencë, situata rrezikon të përshkallëzohet në një krizë të heshtur shëndetësore.

12.1.Rekomandimi: Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me Njësitë Vendore të Shëndetit Publik, të vlerësojnë në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme riskun shëndetësor për popullatën që jeton në zonën Patos–Marinëz, e cila përfshin fshatrat Zharrëz, Marinëz, Kuman, Sheqishte, Jagodinë etj. Duke qenë se këto komunitete ndodhen në afërsi të burimeve të nxjerrjes së naftës dhe gazit natyror, është thelbësore të planifikohen dhe të realizohen studime të mirëstrukturuara epidemiologjike, me qëllim sigurimin e të dhënave të mjaftueshme, të sakta dhe të besueshme mbi ndikimin që kjo industri ka në shëndetin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1.Rekomandimi: Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa për të krijuar një sistem të integruar dhe të informatizuar me sistemet e tjera të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave shëndetësore në nivel vendor dhe kombëtar, i cili:

- Të sigurojë standardizimin e metodologjisë së raportimit ndërmjet ISHP dhe Njësite Vendore të Kujdesit Shëndetësor;
- Të mundësojë verifikimin periodik të të dhënave shëndetësore për të identifikuar mospërputhjet dhe për të korrigjuar informacionin e pasaktë;
- Të përfshijë komponentin e monitorimit shëndetësor proaktiv në zonat me rrezik të lartë mjedisor, siç janë ato me aktivitet të lartë të nxjerrjes së naftës;
- Të garantojë transparencë publike dhe raportim të rregullt mbi gjendjen shëndetësore të popullatës, në lidhje me ekspozimin ndaj ndotësve mjedisorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1.Rekomandimi: Instituti i Shëndetit Publik të kryejë një studim për analizimin e rasteve me sëmundje malinje të regjistruara gjatë periudhës raportuese për popullatën që jeton në afërsi të burimeve të naftës dhe gazit natyror. Kjo analizë duhet të shërbejë për vlerësimin e ndikimit të mundshëm të ndotjes mjedisore në shëndetin publik dhe për orientimin e masave parandaluese apo ndërhyrëse për mbrojtjen e komuniteteve të ekspozuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.4 Si janë shpenzuar nga bashkitë, të ardhurat e realizuar nga taksat, që paguajnë kompanitë e nxjerrjes së naftës?

Ligji 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” përcakton se Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe mund të vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribuueshëm për aktivitetin në fjalë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të burimeve të tyre financiare, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobi të qytetarëve ku përfshihen dhe ato mjedisore. Lidhur me këto të drejta e detyrime grupi i auditimit ka kërkuar të njihet me shpenzimet e kryera në fushën mjedisore e posaçërisht ato investime që lidhen direkt me ndikimin në mjedis e shëndet të qytetarëve. Kryesisht lidhur me çështjet mjedisore ato duhet të orientohen në objektiva të qarta e të lidhura ngushtë me ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror, duke siguruar që burimet natyrore të përdoren në një mënyrë që plotësojnë nevojat e sotme pa rrezikuar mundësitë e brezave të ardhshme. Nga informacioni i marrë nga bashkitë që shtrihen në zona ku ushtrohet aktiviteti i nxjerrjes së naftës, rezulton se nga të ardhurat nga renta e tarifave e

ndotjes, investimet në fushën mjedisore janë në nivel shumë të ulët ose janë kryesisht të orientuara në infrastrukturë dhe në menaxhimin e mbetjeve urbane, duke lënë jashtë fokusit investime që kanë të bëjnë me riaftësimin e zonave të ndotura nga aktiviteti i shfrytëzimit të naftës.

➤ *Bashkia Patos dhe Roskovec, investime minimale për përmirësimin e mjedisit në raport me të ardhurat nga tarifët e ndotjes...*

• **Bashkia Patos**

Totali i të ardhurave të përfituara nga renta minerare për bashkinë Patos, për vitet 2021-2024 është 301,582 mijë lekë, ndërsa nga mbledhja e tarifës e ndotje mjedisi/përmirësim mjedisi është 171,319 mijë lekë.

Gjatë periudhës 2021-2024, Bashkia Patos për përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonën Patos-Marinëz ka zhvilluar 2 projekte pyllëzimi, përkatësisht në fshatin Zharrëz me sipërfaqe 0,57 ha me dru të llojit eukalipt si dhe pyllëzimi i sipërfaqes prej 0,84 ha në fshatin Belinë me dru të llojit eukalipt.

-Në fshatin Belinë gjatë vitit 2024, zona e cila është pyllëzuar ndodhet përgjatë argjinaturës së lumit “Seman” në ngastrën pyjore 3d1. Nga vrojtimi në terren rezulton se qëllimi i pyllëzimit të kësaj ngastre është të mbrojë argjinaturën nga erozioni i lumit “Seman” dhe ndodhet larg puseve të naftës e zonave të banuara. Ky investim ka një vlerë prej 485,520 lekë dhe përbëhet nga 2,380 copë fidanë të llojit eucalipt të mbjella me skemën 3 x 3 metër duke mbajtur parasysh konfiguracionin e terrenit në këtë zonë. Duke marrë parasysh largësinë nga zonat e banuara dhe jo pranë puseve të naftës, ky investim është jo efektiv lidhur me ndikimin në cilësinë e ajrit dhe nuk parandalon ndotjen. Qëllimi i pritshëm dhe me rezultat mund të jetë ai i parandalimit të gërryerjeve nga erozioni.

-Gjithashtu, në fshatin Zharrëz gjatë vitit 2023, në vendin e quajtur “Përroi i Zharrëzës” është kryer mbjellja e një sipërfaqeje prej 0,57 ha me dru të llojit eukalipt me një vlerë prej 148,122 lekë. Nga vëzhgimi në terren i këtij investimi ka rezultuar se pyllëzimi është kryer në zonë të përshtatshme dhe pranë një pusi naftë dhe zonave të banuara. Ndryshe nga investimi përgjatë argjinaturës së lumit “Seman”, ndonëse në vlerë edhe më të vogël, rezulton se parimet e input-output janë të vlefshme për këtë investim.

- *Vlen të theksojmë se investimet në mjedis lidhur me përmirësimin e cilësisë së ajrit në raport me të ardhurat nga tarifa e ndotjes, janë minimale dhe nuk ju kthehen qytetarëve.*

• **Analizë e shpenzimeve në mjedis krahasuar me ato të ndryshme.**

Totali i të ardhurave të përfituara nga renta minerare për bashkinë Patos, për vitet 2021-2024 është 301,582 mijë lekë, ndërsa nga mbledhja nga tarifa e ndotjes së mjedisit është 171,319 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme paraqitet dhe pesha në buxhet në përqindje sipas viteve.

Tabela.21 Të ardhurat e realizuara nga renta minerare dhe tarife ndotje/përmirësim mjedisi dhe pesha në buxhet.

Përshkrimi i të ardhurave	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Renta Minerare	79,468	71,246	75,434	75,434
<i>Pesha në buxhet</i>	<i>32.4%</i>	<i>35%</i>	<i>31%</i>	<i>26.3%</i>
Tarifë ndotje	47,985	40,250	41,103	41,979
<i>Pesha në buxhet</i>	<i>19.6%</i>	<i>19.7%</i>	<i>17.1%</i>	<i>14.6%</i>
Totali	127,453	111,496	116,537	117,413

Burimi: Sipas të dhënave vënë në dispozicion nga Bashkia Patos.

Përpunoi Grupi i Auditimit

Kjo analizë shqyrton përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga tarifa e ndotjes në mjedis nga Bashkia Patos gjatë periudhës 2021–2024, duke u fokusuar veçanërisht në fondet e alokuara për pyllëzim si një ndër format më të drejtpërdrejta të përmirësimit të cilësisë mjedisore.

Tabela.22. Vlera e investimeve të mbuluara nga renta minerare dhe tarifa e ndotjes në mjedis/përmirësim mjedisi.

Viti	2021	2022	2023	2024
Shuma totale e investimeve	110,341,000	110,314,000	196,260,104	179,769,449
Mbuluar nga Renta	79,468,000	71,246,000	55,493,779	57,297,603

Burimi: Bashkia Patos.

Tabela nr.23. Shuma e mbledhur e tarifës së ndotjes dhe përdorimi i tyre.

Viti	2021	2022	2023	2024
Shuma totale e realizimit të tarifës së ndotjes.	47,985,900	40,250,900	41,103,200	41,979,200
Totali i shpenzimeve për Programin "Menaxhimi i mbetjeve - Mbrojtja e Mjedisit".	33,811,000	38,637,407	45,926,796	54,928,659

Burimi: Bashkia Patos.

Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë se si janë administruar të ardhurat nga tarifa e ndotjes në mjedis nga Bashkia Patos gjatë periudhës 2021–2024, me fokus tek përdorimi i këtyre fondeve për përmirësimin e cilësisë mjedisore përmes projekteve të pyllëzimit. Tarifa e ndotjes është një instrument financiar që synon të sigurojë burime për mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit, ndaj përdorimi i saj duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me investime konkrete në këtë drejtim.

Tabela nr.24 Të dhënat mbi shpenzimet e kryera në mjedis dhe peshë krahasuar me totalin:

Përshkrimi	Vlera (lekë)	Përqindje ndaj të ardhurave (%)
Të ardhura nga tarifa e ndotjes (2021–2024)	171,319,200	100%
Shpenzime për pyllëzim	633,642	0.37%
Shuma e shpërndarë për investime të tjera dhe programe të ndryshme	170,685,558	99.63%

Burimi: Bashkia Patos.

Përpunoi: Grupi i auditimit.

• **Praktika të Mira Mjedisore në rajon⁷⁶**

1. Pyllëzimi dhe Ripyllëzimi Kompensues. Një nga praktikat më të mira për zbutjen e ndikimeve nga nxjerrja e naftës është mbjellja e pemëve në zonat e prekura. Kjo ndihmon në uljen e ndotjes, riparimin e ekosistemit dhe rivendosjen e biodiversitetit.

Shembull i Detajuar: Pyllëzimet Kompensuese në Drenas, Kosovë .

Në komunën e Drenasit, e cila përfshin disa zona të shfrytëzimit industrial dhe minerar, janë realizuar projekte të pyllëzimit dhe ripyllëzimit të drejtuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Kosovës. Programi përfshiu mbjelljen e më shumë se 50,000 fidanëve në sipërfaqe të degraduara nga industria përpunuese dhe minierat e hapura. Përzgjedhja e specieve u bë në bashkëpunim me institucionet shkencore, duke u fokusuar në pisha të zeza, akacie dhe dushqe autoktone që përshtaten me kushtet klimatike lokale. Krahas mbjelljes, u realizuan edhe aktivitete të edukimit me komunitetin lokal, duke përfshirë shkollat dhe organizatat rinore për të promovuar ruajtjen e hapësirave të gjelbra dhe monitorimin e pyjeve të reja. Financimi u mbështet pjesërisht nga donatorë ndërkombëtarë si G. dhe A., si dhe nga buxheti i shtetit kosovar. Raportet e monitorimit pas 2 vitesh treguan përmirësim të dukshëm të cilësisë së tokës dhe ulje të pluhurit në ajër përreth zonës industriale.

• **Bashkia Roskovec.**

Në Bashkinë Roskovec, tarifa e ndotjes ka filluar të zbatohet në vitin 2022 - 2024.

Bashkia Roskovec, ka përfituar nga renta minerare shumë më 169,084 mijë lekë. Tarifën e ndotjes së mjedisit në Bashkinë Roskovec e ka likujduar vetëm subjekti "Albpetrol" sh.a në shumë më 2,000, 000 lekë për vitin 2024, ndërsa për vitet e tjera nuk ka likujdim të kësaj tarife, pavarësisht planifikimit.

⁷⁶ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës (2020), Raport mbi pyllëzimet në Drenas

Gjatë periudhës 2021-2024 Bashkia Roskovec për përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonë nuk ka zhvilluar asnjë projekt apo investim në këtë fushë. Investimet kryesisht kanë shkuar për infrastrukturë dhe paraqiten në vlerë totale 52,724,463 lekë, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion dhe paraqitet sipas objekteve të listuara më poshtë.

Tabela nr.25. Investimet e kryera nga Bashkia Roskovec.⁷⁷

Viti 2021	Vlera në lekë
Rikualifikim urban në fshatin Marinëz(Ruga "Llambi Marku")	6,000,000
Rikonstruksion i rrugës së kishës, fshati Marinëz .	3,500,000
Viti 2022	
Rikonstruksion rruga "Lagjia e Naftës", kodër.	9,815,940
Rikonstruksion i rrugës së kishës, fshati Marinëz.	3,520,127
Rikualifikim urban në fshatin Marinëz, Rruga "Llambi Marku"	6,033,934
Rikonstruksion i rrugës rrethrotullimi "Vajza Myzeqare" Marinëz	4,99,712
Rikonstruksion i rrugës rrethrotullimi "Vajza Myzeqare" Marinëz	999,996
Viti 2023	
Rikonstruksion i rrugës rrethrotullimi "Vajza Myzeqare" Marinëz	4,553,280
Rikonstruksion i rrugës rrethrotullimi "Vajza Myzeqare" Marinëz	6,387,238
Viti 2024	
Sistemimi i Qendrës Marinëz. Ndërtim Rrethrotullimi	7,414,236
Totali 2021-2024	52,724,463

Burimi: Bashkia Patos, përpunuar nga grupi i auditimit.

Përpunoi: Grupi i auditimit.

Përdorimi i kufizuar i fondeve të mbledhura nga tarifa e ndotjes dhe mosrealizimi i projekteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit i jep mundësi shumë të ulta Bashkisë Roskovec për të trajtuar problemet e ndotjes dhe të ndikimit të saj në shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Edhe pse Bashkia ka alokuar investime në infrastrukturë në shumën 52,724,463 lekë, mungesa e alokimit të fondeve për një mjedis të pastër tregon një disbalancë mes prioriteteve infrastrukturore dhe nevojës për të adresuar përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit.

15.Gjetje: Gjatë periudhës 2021-2024, Bashkia Patos ka mbledhur gjithsej 171.3 milionë lekë nga tarifa e ndotjes në mjedis/përmirësim mjedisi. Megjithatë, nga kjo shumë, vetëm 633 mijë lekë janë përdorur për pyllëzim, një formë thelbësore për uljen e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Kjo përfaqëson vetëm 0.37% të totalit të të ardhurave nga kjo tarifë. Kjo nënkupton se mbi 99% e fondeve janë të përdorura për qëllime të tjera, duke ngritur shqetësime serioze për mungesën e eficiencës në administrimin e burimeve mjedisore. Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore"⁷⁸ përcakton se, bashkitë janë përgjegjëse për sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Mospërdorimi i fondeve për projekte konkrete mjedisore bie ndesh me frymën dhe qëllimin e vendosjes së kësaj tarife. Në Bashkinë Patos, e cila ndikohet drejtpërdrejt nga industria nxjerrëse dhe ndotja e ajrit dhe tokës e kryesisht në fshatin Zharrëz, nevoja për ndërhyrje mjedisore është e lartë dhe urgjente. Niveli i ulët i investimeve në këtë drejtim jo vetëm që përfaqëson një mangësi në menaxhimin buxhetor por edhe një dështim për të kthyer të ardhurat publike në përfitime konkrete për qytetarët. Shkak për këtë gjendje kryesisht janë:

- Mungesa e një plani të integruar lokal mjedisor;
- Kapacitete të kufizuara administrative për të projektuar dhe zbatuar ndërhyrje efektive;
- Mungesa e sipërfaqes së ekonomisë pyjore;
- Mungesë koordinimi ndërmjet bashkisë me aktorë të tjerë shtetërorë si (Albpetrol sh.a) apo privat për prioritizimin e ndërhyrjeve në mjedis.

16.Gjetje: Bashkia Roskovec ka vendosur tarifa për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e nxjerrjes së naftës brenda territorit të saj dhe ka përfituar nga renta minerare shumën 169,084 mijë lekë për periudhën 2021-2024, ndërsa nga tarifa e ndotjes së mjedisit ka krijuar në vitin 2024, vetëm shumën 2,000,000 lekë. Përdorimi i të ardhurave nga këto zëra nuk e kushtëzon Bashkinë në përdorimin e këtyre fondeve. Gjatë periudhës 2021-2024, Bashkia Roskovec nuk

⁷⁷ E-mail zyrtar Bashkia Roskovec, datë 24.04.2025

⁷⁸ Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 26, pika.1

ka zhvilluar asnjë projekt apo investim për përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonë, duke e lënë kështu një mundësi të humbur për të adresuar problemet e ndotjes.

6.Konkluzion:

-Gjatë katër viteve, Bashkia Patos ka mbledhur gjithsej 171.3 milionë lekë nga tarifa e ndotjes në mjedis/përmirësim mjedisi. Megjithatë, nga kjo shumë, vetëm 633 mijë lekë janë përdorur për pyllëzim, një formë thelbësore për uljen e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Kjo përfaqëson vetëm 0.37% të totalit të të ardhurave nga kjo tarifë. Kjo nënkupton se mbi 99% e fondeve janë të përdorura për qëllime të tjera, duke ngritur shqetësime serioze për mungesën e eficiencës në administrimin e burimeve mjedisore.

-Bashkia Roskovec ka një performancë jo të mirë lidhur me investimet në mjedis, për shkak se pjesa më e madhe e të ardhurave që krijohen nga mbledhja e taksave (renta minerare) si dhe tarifave (tarifë ndotje nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në nxjerrje të naftës dhe gazit), ka si destinacion kryesisht infrastrukturën. Shpenzimet e kryera gjatë vitit 2021-2024, nuk kanë pasur si destinacion fushat mjedisore e kryesisht ato me ndikim në përmirësimin e cilësisë së ajrit apo tokës, për banorët pranë zonave ku ushtrohet aktiviteti i nxjerrjes së naftës.

15.1.Rekomandim: Bashkia Patos gjatë hartimit dhe planifikimit të shpenzimeve të buxhetit vjetor dhe afatmesëm, të marrë në konsideratë me vëmendje të shtuar, përdorimin e fondeve për investime mjedisore, në mënyrë që:

- Të sigurohet përdorim efektiv i fondeve për përmirësimin real të kushteve mjedisore;
- Të rritet eficensa përmes orientimit të fondeve në projekte me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet;
- Të vendosen mekanizma për matjen dhe raportimin e rezultateve të arritura, në mënyrë që çdo lekë i shpenzuar të justifikohet me përfitime të prekshme për qytetarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1.Rekomandim: Bashkia Roskovec të marrë masa në realizimin e investimeve mjedisore e të programojë projekte të qëndrueshme mjedisore e sociale për përmirësimin e cilësinë e ajrit, reduktimin e ndotjes, mbjelljen e pemëve dhe krijimin e zonave të gjelbra si dhe monitorimin e masave për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja.

Në vijimësi

5.ANEKSE

5.1 Observacionet e subjekteve

1. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, Bashkia Kuçovë ka paraqitur observacione me shkresë nr.143/22 prot., datë 12.08.2025, ardhur në KLSH me nr.129/42 prot., datë 18.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Pretendimi i subjektit: Administrata e Bashkisë Kuçovë u njoh dhe analizoi me përgjegjshmëri projekt raportin “Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz”, pohojmë faktin se nuk gjenden komente dhe shpjegime vijuese, për shkak të vërtetësisë së gjetjeve dhe rekomandimeve të cituara.

2. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka paraqitur observacione me shkresë nr. 2638/3 prot., datë 31.07.2025, ardhur në KLSH me nr. 129/40 prot., datë 04.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Pretendimi i subjektit: Lidhur me rekomandimin 6.1, në të cilën kërkohet që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për vendosjen e një stacioni për matjen e të gjithë parametrave mjedisorë në zonën Patos-Marinëz dhe të informojë publikun në rast të kapërcimit të normave të lejuara, ju bëjmë me dije se: MTM ka paraqitur pranë Ministrisë së Financave përmes raportit të PBA-së 2025-2027, faza e dytë(shkresa me nr. 5528 prot., datë 02.09.2024) kërkesën për miratimin e fondeve për blerjen e 10 stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

-Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Sipas Vendimit Nr. 412, datë 19.06.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”, Ministria e Mjedisit së bashku me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit janë autoritete kompetente për modernizimin dhe përmirësimin e rrjetit të monitorimit. Zona Patos-Marinëz është klasifikuar si një zonë e nxehtë mjedimore dhe ende nuk ka një stacion të monitorimit të parametrave mjedisorë.

3. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit e ka deleguar zbatimin e rekomandimeve të lëna (projekt raportin), pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë (email i sjellë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit).

4. Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është paraqitur observacioni me nr. 284/5 prot., datë 13.08.2025 si më poshtë:

-Pretendimet e subjektit:

-Lidhur me rekomandimin 3.1, shprehet dakord për zbatimin e tij;

-Lidhur me rekomandimin 12.1, kërkohet të ndryshohet fjalia “*Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me strukturat e tij rajonale*” dhe të bëhet “*Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Njësitë Vendore të Shëndetit Publik... pasi ISHP nuk ka struktura rajonale*”.

-Lidhur me rekomandimin 13.1, e cila kërkon krijimin e një sistemi të unifikuar dhe të integruar të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave...., sqarohet në shkresë së funksionon një sistem i unifikuar, metodologjia është e unifikuar, të dhënat janë në kohë reale dhe ISHP garanton transparencë.

-Lidhur me rekomandimin 14.1 e cila lidhet me tendencën rritëse të sëmundjeve malinje sidomos në zonën e Fierit, sqarohet se sipas të dhënave të paraqitura në këtë shkresë, se Fieri nuk paraqet të dhëna shqetësuese, pasi niveli i incidencës është pak më i lartë sesa mesatarja kombëtare, konkretisht për vitin 2024 është 318/100000 banorë, për vitin 2023 279/100000 banorë, dhe kërkohet që rekomandimi të riformulohet.

-Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Për rekomandimin 3.1 jeni shprehur dakord.

Për rekomandimin 12.1, pranohet qëndrimi juaj, duke u bërë ndryshimi i fjalisë nga “*Strukturat e tij rajonale*”, në “*Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor*”;

Për rekomandimin 13.1, pranohet pjesërisht qëndrimi juaj, pasi edhe referuar takimit të mirëkuptimit, u konsiderua e nevojshme krijimi i një sistemi të integruar dhe të informatizuar me sistemet e tjera, pasi ISHP nuk dispononte një sistem të informatizuar;

-Për rekomandimin 14.1, përfaqësuesit e ISHP, pranuan përgjatë takimit të mirëkuptimit se të dhënat e dërguara me e-mail nuk përfaqësojnë të dhënat e sakta, duke evidentuar sidomos të dhënat për sëmundjet malinje në zonën e Fierit. Sqarojmë se rekomandimi qëndron, por është evidentuar gjetje me rezerva për të dhënat e paraqitura.

Aneksi 5.2 Foto të kryera gjatë vizitave në teren nga grupi i auditimit.

Foto nr.6 Mbetje hidrokarburesh në ujërat sipërfaqësor dhe në tokë



Foto nr. 7. Pus i ri në shfrytëzim.





Foto nr. 8. Pus shfrytëzimi afër banesave dhe zonës së mbjellë me agrokulturë.



Foto nr. 9. Depozitat e grumbullimit të abandonuara.



Foto nr.10. Puse të abandonuar.







KONTROLLI I LARTË I SHTETIT